

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSIT
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEMA:

“Procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare me theks të posaçëm në Gjykatën themelore civile Shkup nga viti 2015 e këndej”

Kandidat:

Drilon Limani

Mentor:

Doc. dr. Albana Metaj-Stojanova

Shkup, 2022

PËRMBAJTJA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	4
Lënda e hulumtimit	6
Qëllimet e hulumtimit.....	8
Hipotezat.....	10
Metodologjia e hulumtimit	11
Rëndësia e punimit	12
Kapitulli I.....	13
PARIMET PROCEDURALE NË PROCEDURAT JASHTËKONTESTIMORE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE FAMILJARE.....	13
1.1 Rëndësia e procedurave jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare.....	13
1.2 Parimet procedurale në procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare	15
1.2.1 Parimi i dispozitivitetit dhe parimi i oficialitetit.....	17
1.2.2 Parimi i shqyrtimit dhe hetimit.....	18
1.2.3 Parimi i dëgjimit të pjesëmarrësve në procedurë.....	18
1.2.4 Parimi i konstatimit të së vërtetës dhe parimi i vlerësimit të lirë të provave.....	21
1.2.5 Parimi i zhvillimit të gjykimit gojariht dhe me shkrim	22
1.2.6 Parimi i pa ndërmjetësisë	23
1.2.7 Parimi i publicitetit	24
1.2.8 Parimi i kujdesit të veçantë për personat që nuk janë në gjendje të kujdesen vetë për të drejtat dhe interesat e tyre	24
1.2.9 Parimi i efikasitetit.....	25
1.2.10 Parimi i interesit më të lartë të fëmijës.....	25
Kapitulli II	27
2. PROCEDURA JASHTËKONTESTIMORE PËR DHËNIEN E LEJES PËR LIDHJEN E MARTESËS	27
2.1 Kushtet thelbësore për lidhjen e martesës dhe pengesat martesore	27
2.1.1 Mituria si pengesë për lidhjen e martesës	30

2.1.2 Martesa ekzistuese si pengesë për lidhjen e martesës.....	31
2.1.3 Forma e manifestuar e sëmundjes psikike, paaftësia për të gjykuar dhe zhvillimi mendor (psikik) i prapambetur si pengesë për lidhjen e martesës	31
2.1.4 Gjinia si pengesë për lidhjen e martesës.....	32
2.1.5 Mangësitë në shprehjen e vullnetit si pengesë për lidhjen e martesës.....	34
2. 2 Instituti i emancipimit	34
2.3 Procedura jashtëkontestimore për dhënien e lejes për lidhjen e martesës.....	35
2.3.1 Objekti i procedurës.....	36
2.3.2 Kompetenca vendore e gjykatës.....	37
2.3.3 Inicimi dhe zhvillimi i procedurës.....	38
2.3.4 Aktvendimi dhe pasojat juridike të aktvendimit.....	40
2.3.5 Mjetet juridike	41
2.3.6 Shpenzimet e procedurës.....	42
 Kapitulli III	 43
3. PROCEDURA JASHTËKONTESTIMORE PËR MARRJEN E TË DREJTAVE PRINDËRORE, PËRCAKTIMIN QË PRINDËRIT TË KENË POZITËN E KUJDESTARIT DHE KTHIMIN E TË DREJTAVE PRINDËRORE	43
3.1 Koncepti i përgjegjësisë prindërore	43
3.1.1 Të drejtat dhe detyrimet personale jopasurore të prindërve ndaj fëmijëve	46
3.1.2 Të drejtat dhe detyrimet ndaj pasurisë së fëmijës.....	51
3.1.3 Kohëzgjatja e përgjegjësisë prindërore	52
3.1.4 Ushtrimi i të drejtës prindërore	52
3.2 Procedura jashtëkontestimore për marrjen e të drejtave prindërore, përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimin e të drejtave prindërore.....	58
3.2.1 Objekti i procedurës.....	58
3.2.2 Kompetenca vendore e gjykatës	60
3.2.3 Inicimi dhe zhvillimi i procedurës.....	60
3.2.4 Aktvendimi dhe pasojat juridike të aktvendimit.....	62
3.2.5 Mjetet juridike	63
3.2.6 Shpenzimet e procedurës.....	64

Kapitulli IV	64
4.PROCEDURA JASHTËKONTESTIMORE PËR VAZHDIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE PRINDËRORE PAS MOSHËS MADHORE	64
4.1 Vazhdimi i të drejtës prindërore pas moshës madhore	64
4.2 Procedura jashtëkontestimore për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore	64
4.2.1 Objekti i procedurës.....	64
4.2.2 Kompetenca vendore e gjykatës.....	66
4.2.3 Inicimi dhe zhvillimi i procedurës	67
4.2.4 Aktvendimi dhe pasojat juridike të aktvendimit	68
4.2.5 Mjetet juridike	69
4.2.6 Shpenzimet e procedurës	71
V. TË DHËNA NGA GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP LIDHUR ME PROCEDURAT JASHTËKONTESTIMORE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE FAMILJARE PËR PERIUDHËN NGA VITI 2015 E KËNDEJ.....	71
5.1 Të dhëna lidhur me procedurën jashtëkontestimore për dhënien e lejes për lidhjen e martesës.	71
Përfundimi	73
Literatura	76

Abstrakt

Punimi i tezës së magjistraturës me temë “Procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare me theks të posaçëm në Gjykatën themelore civile Shkup nga viti 2015 e këndej” ka për qëllim të jep një pasqyrë se si janë rregulluar marrëdhëniet familjare në procedurat jashtëkontestimore në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut dhe në procedurat përpara Gjykatës themelore civile në Shkup.

Ligji për procedurë kontestimore përcakton se, sipas rregullave të procedurës kontestimore do të debatohet dhe vendoset në konteste të marrëdhënieve personale dhe familjare, të marrëdhënieve të punës, si dhe të marrëdhënieve pronësore dhe marrëdhënie tjera civile-juridike të personave fizik dhe juridik, përveç nëse për disa prej tyre me ligj të veçantë nuk është parashikuar që gjykata të vendosë sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër (p.sh. jashtëkontestimore).

Kjo, sepse edhe në procedurën jashtëkontestimore vendoset për marrëdhënie dhe raporte personale, familjare dhe pronësore. Gjendje familjare të cilat rregullohen në procedurë jashtëkontestimore janë: 1) procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës; 2) procedura për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimin e të drejtave prindërore dhe 3) procedura për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore.

Në fokus të këtij punimi është pikërisht analizimi i këtyre procedurave si në aspektin legjislativ, ashtu dhe në aspektin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Civile të Shkupit nga viti 2015 e në vazhdim.

Fjalë kyçe: *procedurat jashtëkontestimore, marrëdhëniet familjare, procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës, procedura për marrjen e ushtrimit të së drejtës prindërore, procedura për vazhdimin e të drejtës prindërore pas moshës madhore*

Апстракт

Магистерската теза на тема „Вонпарнични постапки за уредување на семејните односи со посебен осврт во Основен граѓански суд Скопје од 2015 година наваму“ има за цел да даде една јасна слика на тоа како се уредуваат семејните односи во вонпарничните постапки според законодавството на Република Северна Македонија, но и во судската практика на Основен граѓански суд Скопје.

Законот за парничната постапка определува дека, според правилата на парничната постапка, ќе се расправа и одлучува во споровите за основните права и обврски на човекот и граѓанинот, за личните и семејните односи на граѓаните како што се работните, трговските, имотните и другите граѓанско-правни спорови, ако со закон за некои од тие спорови не е определено за нив судот да решава според правилата на некоја друга (на пример вонпарнична) постапка.

Тоа е така, затоа што и во вонпарничната постапка се одлучува за лични, семејни и имотни односи. Семејни односи кои се уредуваат во вонпарничната постапка се: 1) давање дозвола за склучување на брак; 2) одземање на вршење на родителски права, определување родителите да имаат положба на старател и враќање на родителските права и 3) продолжување на родителските права и должностите по полнолетството.

Во фокус на овој труд е токму анализата на овие постапки, како од аспект на законското уредување, така и од аспект на судската практика на Граѓанскиот суд Скопје од 2015 година наваму.

Клучни зборови:*вонпарнична постапка, семејни односи, постапка за давање дозвола за склучување на брак, постапка за одземање на вршење на родителски права, постапка за продолжување на родителските права по полнолетството*

Abstract

The Master thesis on the topic “Non-contentious procedures for the regulation of family relations with special emphasis on the Basic Civil Court Skopje from 2015 onwards” aims to give an overview of how family relations are regulated in non-contentious procedures in the legislation of the Republic of North Macedonia and in court proceedings of the Basic Civil Court in Skopje.

The Law on contentious procedure determines that, according to the rules of the contentious procedure, disputes regarding personal and family relations, labor relations, as well as property relations and other civil-legal relations of natural and legal persons will be debated upon and decided, unless for cases when by special law, it is provided that the court will decide according to the rules of any other (e.g., non-contentious) procedure.

This is so, because in non-contentious procedures is also decided about personal, family and property relations. Family relations that are regulated in non-contentious procedure are: 1) the procedure for granting a marriage license; 2) the procedure for the removal of the exercise of parental rights, the determination that parents have the position of guardian and the return of parental rights and 3) the procedure for the continuation of parental rights and obligations after adulthood.

The focus of this thesis is precisely the analysis of these procedures both in terms of legislation and in terms of judicial practice of the Civil Court in Skopje from 2015 onwards.

Keywords: *non-contentious procedures, family relations, procedure for granting a marriage licence, procedure for the removal of parental responsibility, procedure for the continuation of parental responsibility after adulthood.*

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nënpërgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar në tërësi në pjesët e veçanta. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fushat adhetë referuar në bibliografi.

Drilon Limani

FALËNDERIM

NjëfalënderimiveçantëitakonmentorittimDoc. dr. Albana Metaj-Stojanovapërndihmëndhesugjerimetkonkretegjatëpërgatitjessëkëtijpunimi, gjithashtuedheanëtarëvetëkomisionit.

Falënderojtëgjithëqëmëndihmuannëgrumbullimin e materialitënevojshëm, pa tëcilëtnuk do tëishteimundurrealizimiikëtijpunimi.

Falënderimetëthellaishprehfamiljessime.

1. Hyrje

Ky punim ka për objekt analizimin e procedurave të veçanta jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare, ku bëjnë pjesë:

- 1) procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës;
- 2) procedura për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimin e të drejtave prindërore dhe
- 3) procedura për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore. Në punim do të analizohet legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe praktika gjyqësore e Gjykatës themelore civile Shkup nga viti 2015 e në vazhdim.

Çështjet jashtëkontestimore mund të jenë standarde, në rastet kur nuk ka interesa të kundërta apo konflikt midis pjesëmarrësve në procedurë, apo jo standarde, në rastet kur ka njëfarë kundërshtie në interesat juridike të pjesëmarrësve, por ligjvënësi ka vendosur procedurën jashtëkontestimore si metodë të mbrojtjes. Sipas qëllimit të mbrojtjes juridike, procedura jashtëkontestimore është procedurë preventive.

Qëllimi i ndërhyrjes së gjykatës është vendosja e sigurisë në marrëdhëniet juridike dhe pengimi i shkeljeve të ardhshme eventuale të të drejtave. Sipas iniciativës për inicimin e procedurës, procedurat jashtëkontestimore ndahet në:

- 1) zyrtare – procedurat që inicohen sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) nga gjykata;
- 2) jozyrtare – procedurat që inicohen me propozim të personave apo organeve të autorizuar, siç mund të jenë p.sh. Qendra për Punë Sociale apo Prokurori publik dhe
- 3) të kombinuara – procedurat që mund të inicohen edhe nga gjykata, edhe me propozim të personave të autorizuar. Procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare janë procedura jo zyrtare që inicohen me propozim të personave të autorizuar ose me propozim të Qendrës për Punë Sociale.

Në procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare gjejmë zbatim disa nga parimet kryesore në të cilat bazohet procedura jashtëkontestimore, siç janë parimi i dispozitivitetit, parimi i shqyrtimit dhe hetimit, parimi i dëgjimit të pjesëmarrësve në procedurë, parimi i konstatimit të së vërtetës, parimi i zhvillimit të gjykimit gojarisht dhe me shkrim, parimi

i pa ndërmjetësisë, parimi i efikasitetit dhe sidomos një rëndësi të veçantë ka parimi i kujdesit të veçantë për personat që nuk janë në gjendje të kujdesen vetë për të drejtat e tyre. Në procedurat për rregullimin e gjendjeve familjare përjashtohet pjesëmarrja e publikut.

Objekt i punimit është dhe analiza e çështjeve gjyqësore jashtëkontestimore të paraqitura në Gjykatën themelore civile Shkup nga viti 2015 e këndej, të cilat do të analizohen të ndara sipas tre llojeve të procedurave të përfshira në procedurat për jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare.

2. Qëllimet e hulumtimit

Sipas legjislacionit të RMV-së mituria konsiderohet si pengesë martesore dhe si shkak për pavlefshmërinë e martesës. Pjekuria për lidhjen e martesës arrihet me moshën madhore, kur fitohet njëkohësisht dhe zotësia e plotë për të vepruar. Në zbatim të Ligjit për familjen, nuk mund të lidhë martesë personi që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç.

Por, për shkaqe të arsyeshme gjykata kompetente mund të lejojë lidhjen e martesës nga persona të mitur që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Kjo është e mundur në rastet kur gjykata në procedurë jashtëkontestimore vërteton se i mituri ka arritur pjekurinë mendore dhe fizike që është e nevojshme për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesa. Në këtë mënyrë, me dhënien e lejes për lidhjen e martesës shmanget efekti i pengesës martesore që ka mituria, ndërsa i mituri fiton zotësinë e plotë për të vepruar nga momenti i lidhjes së martesës, në bazë të institutit të emancipimit. Një nga qëllimet kryesore të këtij punimi është analizimi i dispozitave ligjore juridiko-materiale dhe juridiko-procedurale që i referohen institutit të emancipimit.

Ekzistojnë situata të caktuara, në të cilat prindërit nuk i zbatojnë detyrimet që kanë ndaj fëmijëve. Kur prindërit i neglizhojnë fëmijët e tyre në aspekt të rritjes dhe edukimit dhe kur ekziston rrezik serioz për rritjen dhe zhvillimin e duhur të fëmijëve mund të vijë deri tek kufizimi i të drejtave prindërore.

Marrja e ushtrimit të të drejtave prindërore është sanksion më i rëndë që ka të bëjë me rastet kur prindërit jo vetëm që nuk i ushtrojnë drejt dhe në mënyrë të ndërgjegjshme të drejtat dhe detyrimet e tyre prindërore, por i lënë pas dore ose i keqpërdorin rëndë detyrimet prindërore. Për dallim nga kufizimi i të drejtave prindërore, që bëhet nga Qendra për Punë Sociale, marrja e të drejtave prindërore kryhet në procedurë jashtëkontestimore.

Megjithatë, marrja e të drejtave prindërore nuk ka karakter të përhershëm, që do të thotë se me ndërprerjen e shkaqeve që kanë çuar në marrjen e të drejtës prindërore, gjykata me vendim ia kthen sërish të drejtën prindërore prindit/prindërve. Gjkata mund të vendosë edhe që prindi të ketë pozitën e kujdestarit. Qëllim i rëndësishëm i këtij punimi është edhe analizimi i dispozitave juridiko-materiale që kanë të bëjnë me marrjen apo kthimin e të drejtave prindërore.

Parakushti kryesor për ekzistencën e të drejtës prindërore është fakti që fëmijët e mitur nuk e kanë pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike që të kujdesen për veten dhe për të drejtat dhe interesat e tyre. Me arritjen e moshës madhore ata arrijnë pjekurinë e duhur dhe fitojnë zotësinë e

plotë për të vepruar. Megjithatë, nëse edhe me arritjen e moshës madhore fëmija, për shkak të mangësive në zhvillimin psikik nuk është në gjendje të kujdeset për veten, të drejtat dhe interesat e veta, legjislacioni i RMV-së parashikon mundësinë e vazhdimit të ushtrimit të të drejtës prindërore në procedurë jashtëkontestimore.

Edhe vazhdimi i të drejtës prindërore nuk ka karakter të përhershëm sepse varet nga ndryshimet në zhvillimin mendor të fëmijës. Kështu që edhe në këtë rast, me ndërprerjen e shkaqeve për të cilat është vazhduar e drejta prindërore gjykata mund të vendosë ndërprerjen e të drejtës prindërore. Një tjetër qëllim i rëndësishëm i këtij punimi është dhe analizimi i dispozitave juridiko-materiale dhe juridiko-procedurale që kanë të bëjnë me vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore edhe pasi fëmija ka arritur moshën madhore.

Gjithashtu, në këtë punim synojmë të sjellim raste nga praktika gjyqësore e Gjykatës themelore civile Shkup, me qëllimin për të analizuar zbatimin në praktikë të dispozitave ligjore dhe pengesat eventuale në këtë drejtim.

Do të sjellim dhe të dhëna statistikore lidhur me rastet e shqyrtuara në këtë gjykatë nga viti 2015 e këndeje të ndara sipas tre kategorive të procedura në fokus:

procedurat për dhënien e lejes për lidhjen e martesës;

- Procedurat për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, përcaktimi që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimi i të drejtave prindërore dhe
- Procedurat për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore.

3. Hipotezat

Hipoteza që parashtrohet në këtë punim është:

- Procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Në këtë punim do të shtrohen pyetje kërkimore të cilave do të përpiqemi t'u përgjigjemi në mënyrë joshteruese.

- Në cilat raste gjykata jep leje për lidhjen e martesës së të miturve mbi moshën 16 vjeç?
- Si zhvillohet procedura jashtëkontestimore për lejimin e lidhjes së martesës nga të miturit mbi moshën 16 vjeç?
- Cilat janë pasojat juridike të lejimit të lidhjes së martesës nga të miturit mbi moshën 16 vjeç?
- Cilat janë shkaqet që çojnë në marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore?
- Në cilat raste gjykata mund të përcaktojë që prindi të ketë pozitën e kujdestarit?
- Në cilat raste gjykata vendos për kthimin e të drejtave prindërore?
- Si zhvillohet procedura jashtëkontestimore për marrjen dhe kthimin e të drejtave prindërore?
- Cilat anë pasojat juridike të marrjes, respektivisht kthimit të të drejtave prindërore?
- Në cilat raste gjykata vendos për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore?
- Si zhvillohet procedura jashtëkontestimore për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore?
- Cilat janë pasojat juridike të vazhdimin të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore?
- Sa të përhapura janë në praktikën gjyqësore procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare?
- Cilat janë problematikat kryesore me të cilat ndeshen gjykatat jashtëkontestimore në procedurat për rregullimin e gjendjeve familjare?

4. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë studim do të përdorim metoda relevante për trajtimin e problematikës në fokus që lidhet me procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare në RMV dhe praktikën gjyqësore me fokus në praktikën gjyqësore të Gjykatës themelore civile Shkup nga viti 2015 e këndej. Do të përdoren metoda të tilla si metoda e rishikimit të literaturës, metoda e analizës, e ndërthurur me metodën krahasuese dhe atë historike.

- Me anën e **metodës së rishikimit të literaturës** do të njihemi me trajtimin juridik që literatura shkencore i ka bërë procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare në RMV. Kjo metodë do të na ndihmojë për të përcaktuar shkaqet për iniciimin e këtyre procedurave, mënyrën e zhvillimit të tyre, pasojat juridike që vendimeve të gjykatës për secilën procedurë, etj.
- **Metoda e analizës ligjore**, e cila do të përdoret gjatë shqyrtimit të normave juridiko-materiale dhe juridiko-procedurale të këtij instituti sipas legjislacionit aktual të RMV-së do të na ndihmojë për të nxjerrë qartë në pah parimet dhe standardet që mbizotërojnë në procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare.
- **Metoda empirike**, e cila do të përdoret për analizën e të dhënave dhe nxjerrjen e gjykimeve e përfundimeve lidhur me çështjen në fokus.
- Në punimin e kësaj teme do të shfrytëzohen dhe vendime të Gjykatës themelore civile Shkup për rregullimin e gjendjeve familjare nga viti 2015 e në vazhdim.

5. Rëndësia e punimit

Rëndësia e punimit është e lidhur me rëndësinë e institutit në fokus të këtij punimi, që është rregullimi i marrëdhënieve familjare në procedurë jashtëkontestimore. Marrëdhëniet familjare janë ndër marrëdhëniet më të rëndësishme juridike, por që mbartin në vetvete dhe një rëndësi të madhe sociale.

Familja është qeliza bazë e shoqërisë dhe mjedisi natyror për rritjen dhe mirëqenien e fëmijës, prandaj familja dhe marrëdhëniet familjare duhet të promovohen e të mbrohen nga legjislacioni dhe organet shtetërore. Procedurat për rregullimin e gjendjeve familjare udhëhiqen nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, që është vendosur si parim udhëheqës nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Kështu, sipas Konventës në të gjitha aktivitetet apo procedurat ku janë të përfshirë fëmijët rëndësi primare kanë interesat e fëmijëve, pavarësisht nëse bëhet fjalë për aktivitete apo procedura që ndërmerren nga institucionet për mbrojtje sociale, nga gjykatat apo organet administrative.

Megjithëse tematike e punimit ka rëndësi të veçantë, kjo është një temë e cila është përpunuar shumë pak ose aspak në doktrinën juridike, gjë që e shton rëndësinë e këtij punimi.

Ky punim ka karakter ndërdisiplinor, ku ndërthuret shqyrtimi dhe analizimi i legjislacionit nga e drejtës materiale civile dhe familjare, dhe njëkohësisht i legjislacionit nga e drejta procedurale jashtëkontestimore.

Në punim do të paraqiten dhe raste konkrete nga praktika gjyqësore për të tre llojet e procedurave në fokus, me synimin për të bërë një pasqyrim të gjithanshëm të tematikës së marrë në shqyrtim, jo vetëm një përpunim teorik, por edhe praktik të çështjes. Synimi është që të paraqiten të dhëna konkrete lidhur me numrin e rasteve të paraqitura e të shqyrtuara në Gjykatën themelore civile Shkup sa i takon secilës procedurë veç e veç.

Pra, sa procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës ka pasur nga viti 2015 e këndej, sa procedura për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, apo përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimin e të drejtave prindërore dhe sa procedura për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore? Gjithashtu, e rëndësishme është që nëpërmjet aktvendimeve gjyqësore të analizuara të nxirren përfundime konkrete lidhur me zbatimin e ligjit nga gjykata dhe problematikat eventuale të hasura në këtë drejtim.

KAPITULLI I

PARIMET PROCEDURALE NË PROCEDURAT

JASHTËKONTESTIMORE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE

FAMILJARE

1.1 Rëndësia e procedurave jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare

E drejta procedurale jashtëkontestimore si pjesë e të drejtës procedurale civile, është sistem normash juridike me të cilat rregullohet struktura e procedurës jashtëkontestimore, pozita dhe roli i subjekteve proceduralë në procedurë, veprimet procedurale që i ndërmarrin subjektet proceduralë dhe pasojat procedurale të tyre, si dhe marrëdhëniet që krijohen midis subjekteve proceduralë lidhur me veprimet dhe vendimet për gjendjet personale, familjare, pronësore dhe gjendjet dhe marrëdhëniet e tjera juridike kur kjo është e përcaktuar me ligj. E drejta procedurale jashtëkontestimore përfshin normat juridike sipas të cilave jepet mbrojtje juridike në punët juridiko-civile për të cilat nuk veprohet sipas rregullave të procedurës kontestimore. Për dallim nga e drejta procedurale kontestimore, e cila përfshin normat juridike sipas të cilave fillimisht jepet mbrojtje juridike për të drejtat subjektive civile të cenuara apo rrezikuara, e drejta procedurale jashtëkontestimore vepron përjashtimisht, pra vetëm në rastet kur kjo është përcaktuar me ligj.¹

Bëhet fjalë për situata kur ligjvënësi ka vlerësuar se me qëllim që të krijohet, ndryshohet ose ndërpritet ndonjë marrëdhënie juridiko-civile, apo të rregullohet ndonjë marrëdhënie ose gjendje juridike, nuk nevojitet vetëm deklarimi i vullnetit të subjekteve në këtë marrëdhënie, por edhe vendim i përshatshëm, ose ndërhyrja e gjykatës apo ndonjë organi tjetër.

Procedura jashtëkontestimore nuk është procedurë e vetme. Atë e përbëjnë numër i madh i procedurave jashtëkontestimore të cilat dallojnë nga njëra-tjetra në aspekt të inicimit, rrjedhës dhe mbylljes, si dhe në aspekt të numrit dhe rëndësisë së pjesëmarrësve në to. Pra, procedura jashtëkontestimore përbëhet nga lloje të veçanta procedurash jashtëkontestimore me objekt të ndryshëm nga njëra-tjetra, me qëllime dhe përmbajtje të ndryshme të mbrojtjes juridike.

¹ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010

Procedurat e veçanta jashtëkontestimore janë:

- *Procedurat për rregullimin e gjendjeve personale*, ku bëjnë pjesë:
 1. procedura për heqjen e zotësisë për të vepruar,
 2. procedura për kthimin e zotësisë për të vepruar,
 3. procedura e mbajtjes në institucion shëndetësor publik për mjekimin e sëmundjeve psikike,
 4. procedura për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur dhe
 5. procedura për vërtetimin e vdekjes.
- *Procedurat për rregullimin e marrëdhënieve familjare*, ku bëjnë pjesë:
 1. procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës,
 2. procedura për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimin e të drejtave prindërore dhe
 3. procedura për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore.
- *Procedurat për rregullimin e marrëdhënieve pronësore*, ku bëjnë pjesë:
 1. procedura për shqyrtimin e trashëgimisë,
 2. procedura për rregullimin e mënyrës së administrimit dhe përdorimit të sendeve të përbashkëta,
 3. procedura për rregullimin e marrëdhënieve midis pronarëve të kateve,
 4. procedura për ndarjen e sendit ose pronësisë së përbashkët,
 5. procedura për rregullimin e kufijve dhe
 6. procedura për përcaktimin e kompensimit për pasuritë e paluajtshme të shpronësuar.
- *Procedurat për vlefshmëri juridike të dokumenteve, për ruajtjen e dokumenteve në gjykatë dhe për depozitën gjyqësore*, ku bëjnë pjesë:
 1. procedura për përpilimin e testamentit gjyqësor,
 2. procedura për anulimin e dokumenteve,
 3. procedura për ruajtjen e dokumenteve dhe
 4. procedura për depozitën gjyqësore.

Ky punim ka në fokus procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Procedura jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare paraqet veprime të

rregulluara me ligj të gjykatës dhe pjesëmarrësve në procedurë, veprime këto të drejtuara drejt në qëllimi të përbashkët, që është ofrimi i mbrojtjes juridike dhe rregullimi i marrëdhënieve familjare për të cilat nuk mund të vepohet sipas rregullave të procedurës kontestimore. Gjykata merret me rregullimin e marrëdhënieve familjare, në të cilat, si rregull, nuk ekzistojnë interesa të kundërt të pjesëmarrësve në procedurë.

Në përgjithësi, punë standarde jashtëkontestimore janë ato punë juridike për të cilat gjykata vendos sipas rregullave të procedurës jashtëkontestimore dhe në të cilat nuk ka kundërshtim midis interesave të pjesëmarrësve në procedurë, pra nuk ka kontest. Ndërsa tek punët jostandarde jashtëkontestimore ekziston njëfarë kundërshtimi midis interesave juridikë të pjesëmarrësve, por për arsye të caktuara juridiko-politike ligjvënësi ka vendosur procedurën jashtëkontestimore si metodë të mbrojtjes.²

Sipas qëllimeve të mbrojtjes juridike, procedura jashtëkontestimore, si rregull, është procedurë parandaluese. Në shumicën e rasteve veprimet e gjykatës ose të organit tjetër kompetent kanë për qëllim rritjen e sigurisë në marrëdhëniet juridike dhe parandalimin e cenimeve të ardhshme eventuale të të drejtave apo të shqetësimeve në ushtrimin e të drejtave.

Edhe përkundër asaj që procedurat jashtëkontestimore llogariten si jokontestuese, në raste të caktuara të procedurës jashtëkontestimore, gjykata diskuton dhe vendos edhe për marrëdhënie kontestuese civile-juridike. Këto procedura quhen procedura jashtëkontestimore kontencioze. Procedura jashtëkontestimore si procedurë gjyqësore ka raport të caktuar me procedurat tjera gjyqësore, me procedurën penale dhe procedurën sipas kontesteve administrative. Si lloj i veçantë i procedurës civile-gjyqësore, procedura jashtëkontestimore ka raporte të caktuara edhe me procedurën kontestimore edhe me atë të përmbarimit.³

1.2 Parimet procedurale në procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare

Parimet e procedurës jashtëkontestimore luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes juridike të të drejtave në procedurë jashtëkontestimore. Parimet janë rregulla themelore

² Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtoro – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 3-4

³ Georgievski, Stefan, "Osnovni principi na gragjanska procesno pravo na R.Makedonija", fq. 78, Monument, Shkup, 1995

të punës, udhërrëfyes për arritjen e qëllimit të caktuar, si dhe postulate mbi të cilat mbështetet procedurajastëkontestimore. Parimet e procedurës jashtëkontestimore janë rregulla të përgjithshme nëpërmjet të cilave shprehen karakteristikat themelore të procedurës jashtëkontestimore si metodë për dhënien e mbrojtjes juridike.

Këto parime e udhëheqin ligjvënësësin në formësimin e institutive procedurale dhe në rregullimin e procedurës jashtëkontestimore. Përveç kësaj, këto parime janë të rëndësishme dhe për ata që i zbatojnë rregullat e procedurës jashtëkontestimore. Në procedurën për dhënie të mbrojtjes juridike, gjatë zbatimit dhe interpretimit të rregullave procedurale, gjykatësi duhet t'i ketë shumë mirë parasysh parimet e procedurës jashtëkontestimore.

Parimet e procedurës jashtëkontestimore mund të grupohen në disa grupe. Disa parime hyjnë në grupin e parimeve të përgjithshme procedurale, të cilat janë të pranishme në të gjitha degët e të drejtës procedurale. Ndërsa, parime të tjera janë parime të përgjithshme të procedurës civile. Ekzistojnë dhe parime që janë specifike vetëm për procedurën jashtëkontestimore, sipas të cilëve ajo dallohet nga procedurat e tjera të mbrojtjes në sferën e marrëdhënieve juridiko-civile.

Për iniciimin e procedurës jokontestimore, në disa çështje juridike vlen parimi i dispozitivitetit, por edhe ai i oficialitetit. Mirëpo, procedura e filluar, pa marrë parasysh se cili e ka inicuar atë, arrin në përfundimin e saj vetëm nën kujdesin e gjykatës.⁴

Pjesëmarrësit në procedurë nuk mund ta përfundojnë atë me anë të veprimeve dispozitive, me të cilat përfundon procedura kontestimore e inicuar me padi. Ky rregull vlen sidomos në çështjet statusore. Mirëpo, tërheqja e propozimit me të cilin është inicuar procedura jokontestimore mund të bëhet deri në momentin e dhënies së vendimit meritore për çështjen juridike.

Ndërsa, parimi i kujdesit të veçantë për personat që nuk janë në gjendje të kujdesen vetë për të drejtat dhe interesat e tyre është parim i veçantë, specifik për procedurën jashtëkontestimore.

1.2.1 Parimi i dispozitivitetit dhe parimi i oficialitetit

⁴Georgievski, Stefan, "Osnovni principi na gragjanska procesno pravo na R. Makedonija", fq. 78, Monument, Shkup, 1995

Parimi i dispozitivitetit dhe efikasitetit – përcakton iniciativën e subjekteve proceduralë për inicimin e procedurës, mbajtjen e saj në rrjedhë, zhvillimin e stadiumeve të procedurës dhe pushimin e procedurës, si dhe disponimin e subjekteve proceduralë me objektin e procedurës dhe me materialin procedural. Të gjitha këto aspekte mund të varen nga iniciativa e palës ose nga iniciativa e gjykatës. Sipas parimit të dispozitivitetit iniciativa varet nga vullneti dhe përcaktimi i palëve në procedurën jashtëkontestimore. Ndërsa sipas sistemit të ofcialitetit iniciativa është në duar të gjykatës.⁵

Parimi i dispozitivitetit të palëve - Palët në tërësi disponojnë me gjitha kërkesat e tyre materialo-juridike dhe proceduralo-juridike dhe lirisht ndikojnë mbi procesin dhe rrjedhën e procedurës. Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, mund t'i tërheqin propozimet e parashtruara, mund t'i pranojnë kërkesat e kundërshtarëve të tyre, etj. Për dallim nga procedura kontestimore ku jepet mbrojtje juridike për të drejtat subjektive civile dhe marrëdhëniet juridiko-civile, të cilat, si rregull, janë të rregulluara me norma dispositive, marrëdhëniet juridike për të cilat vendoset në procedurë jashtëkontestimore janë të rregulluara kryesisht me norma imperative (*ius cogens*). Kjo flet për faktin se në procedurë jashtëkontestimore theksohet interesi i përgjithshëm (publik), për dallim nga procedura kontestimore ku dominon interesi privat i palëve. Dominimi i interesit publik shprehet me dominimin e parimit të ofcialitetit kundrejt parimit të dispozitivitetit. Në inicimin e procedurës jashtëkontestimore vijnë në shprehje të dyja parimet. Sipas parimit të dispozitivitetit, procedura jashtëkontestimore inicohet me propozim të personit ose organit të autorizuar.⁶ Vazhdimi dhe mbajtja në rrjedhë e procedurës së iniciuar në këtë mënyrë varet nga vullneti i propozuesit të autorizuar sepse ai mund ta tërheqë propozimin dhe në këtë mënyrë të vijë deri tek ndalimi i procedurës jashtëkontestimore. Gjithsesi, procedura e filluar me propozim vazhdohet dhe përfundohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare.

Parimi i ofcialitetit – është mbizotërues në procedurën jashtëkontestimore, për dallim nga procedura kontestimore. Procedura mund të inicohet dhe nga gjykata sipas detyrës zyrtare, në rastet e përcaktuara me ligj. Parimi i ofcialitetit shprehet më tepër në faktin se gjykata nuk është e lidhur nga kërkesat e bëra nga propozuesit në procedurë jashtëkontestimore.

⁵ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 19

⁶ Neni 2, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 9/2008)

1.2.2 Parimi i shqyrtimit dhe hetimit

Parimi i shqyrtimit dhe hetimit - Këto parime paraqesin metoda pune dhe i përgjigjen pyetjes lidhur me iniciativën për mbledhjen e materialit procedural në bazë të të cilit gjykata sjell vendimin mbi propozimin. Sipas sistemeve procedurale të cilat janë të bazuara në përdorimin konsekuent të parimit të shqyrtimit, iniciativa për grumbullimin e materialit procedural u njihet vetëm palëve, ndërsa në sistemet procedurale të cilat janë të bazuara në zbatimin konsekuent të parimit të hetimit iniciativa për grumbullin e materialit procedural i takon gjykatës.

Për dallim nga procedura kontestimore në të cilën dominon parimi i shqyrtimit, në procedurën jashtëkontestimore gjykata ka më tepër autorizime për të hetuar. Kjo vjen si pasojë e mbrojtjes më të madhe të interesit publik në punët juridike që janë objekt i procedurës jashtëkontestimore. Mbizotërimi i parimit të hetimit vlen dhe në aspekt të provave. Pra, gjykata mund të paraqesë dhe prova të cilat pjesëmarrësit në procedure nuk i kanë propozuar.⁷

1.2.3 Parimi i dëgjimit të pjesëmarrësve në procedurë

Parimi i dëgjimit të palëve - Për të drejtat e pjesëmarrësve në procedurë, gjykata jashtëkontestimore vendos pas grumbullimit të deklaratave nga ata. Ky është parimi më i vjtër i së drejtës procedurale civile i njohur edhe si parim i kontradiktorialitetit esenca e të cilit qëndron në faktin se gjykata çdo njërës nga palët jepë mundësi që të deklarohet lidhur me kërkesat dhe pretendimet e palës kundërshtare.

Procedura civile në të shumtën e rasteve paraqet ekzistimin e kontestit apo mosmarrëveshjes mes palëve apo të dëmtuarve në proces në të cilin njëra nga palët pretendon për të drejtën e vet e cila i është rrezikuar, shkelur, me çka vërehet se është bërë prishja e marrëdhënieve juridiko civile, dëmtimi i të drejtave subjektive civile, dhe për të vënë në rend ekuilibrin e të drejtës së dëmtuar, për të rregulluar rendin juridiko-shoqërorë inicohet procedura civile.

Procedura civile na paraqitet si metodë, mënyre e cila ndihmon në zgjidhjen e kontestit mes palëve të cilët i drejtohen për ndihmë organeve shtetërore siç është gjykata në të cilën

⁷Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtora – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 21

zhvillohet procedura, e cila ka qëllimet e saj të caktura në dhënien e ndihmës juridike personave të dëmtuar apo të rrezikuar me qëllim që t'i mbrojë ata dhe të japë një vendim meritore dhe ligjor të zgjidhjes së kontestit.

Ndihma juridike të cilën procedura ka për qëllim ta ofrojë nuk jepet pa respektimin e parimeve mbi të cilën është e ndërtuar vetë procedura, parime të cilat udhëzojnë për realizimin e qëllimit të procedurës civile.⁸

Si parim fundamental i procedurës civile moderne, rëndësia e tij shprehet përmes rregullit, sipas të cilit gjykata ka për detyrë themelore sjelljen e vendimit gjyqësor i cili duhet të jetë meritore dhe i ligjshëm, të zhvilloj procedurë në të cilën do t'i jepë mundësi dhe hapësirë secilës nga palët që të shpreh qëndrimin e saj në lidhje me kërkesat, propozimet dhe udhëzimet e kundërshtarit të tij, të japë sqarim për pyetjet për të cilat me vendim gjyqësor duhet të kontestohen, tu sigurojë palëve pjesëmarrje aktive në grumbullim dhe prezantim të faktëve si dhe barazi subjektive për tu zgjedhur, çështja konkrete juridike në mënyrë meritore.

Parimi i kontradiktorialitetit është një ndër parimet themelore të procedurës. Ky parim ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e procedurës në mënyrë të drejtë dhe ligjore, për çka mund të themi edhe se nuk mund të paramendohet procedurë e rregullt në asnjë sistem ligjor pa respektimin e këtij parimi. Në shumë shtete europiane ky parim rangohet në parimet kushtetuese si në kushtetutën e Gjermanisë, Italisë, dhe Zvicrës.

Mund të themi se në këtë parim është e inkorporuar e drejta e palëve në realizimin e mbrojtjes së të drejtave të tyre, nëpërmjet mundësisë së shprehjes logjike dhe mundësisë së mbështetjes së mbrojtës tyre. Dëgjimi i të dyja palëve është përdorur edhe si moto e shumë organizatave të ndryshme politike, gjithashtu si parim i përgjithshëm i racionalitetit në arritjen e konkluzioneve në çështjet e diskutueshme. “Dëgjoni të dyja palët”, është përdorur si pjesë e urtësisë së përbashkët nga ana e dramaturgëve të lashtë në Greqi, gjithashtu një parim të ngjashëm mund ta hasim edhe në ligjin islamik duke u bazuar në njëhadith që tregon se në çështjet gjyqësore të dyja palët duhet të dëgjohen, dhe në të tjera vende ku bëhet praktikimi i këtij parimi.

Parimi i dëgjimit të të dyjave palëve kufizohet në rregullin, sipas së cilit çdonjëri nga palët duhet t'i mundësohet “*mutatis mutandis*” që t'i ndërmarrë të gjitha ato veprime procedurale që mund t'i ndërmarrë edhe pala tjetër në procedurë.

⁸ Brestofci, Faik, “E drejta e Procedurës civile I”, fq. 12, Prishtinë, 2004

Kjo parasë gjithash ka të bëjë me ato veprime procedurale, me të cilat palët i parashtrojnë kërkesat e tyre, qëndrimet, propozimet, pretendimet për fakte, deklaratat për çështje relevante si dhe reagimet ndaj qëndrimeve, kërkesave, propozimeve, pretendimeve dhe deklaratave të kundërshtarit të vet.⁹

Pra, qëllimi i parimit është që me ndërmarrjen e veprimeve të palëve të respektohen të drejtat e tyre subjektive dhe interesi i tyre juridik në procedurë civile, respektimi i shprehjes së tyre të jetë në nivel të lartë dhe mos të jenë prezentë vetëm si pjesmarrës objektiv, barazia mes palëve të jetë absolute dhe t'u mundësohet që për të gjitha kërkesat që shqyrtohen të dëgjohen palët dhe mos të sillet vendim pa mos shqyrtim të kërkesave për të cilat palët do të deklarohen.

Rëndësia e shprehjes përmes këtij parimi palëve u jep mundësinë që ato pa asnjë pengesë dhe trysni t'i shprehin mendimet e tyre, ta parqesin qëndrimin e tyre në lidhje me kërkesat e kundërshtarit, të japin mendime të ndryshme, teza të ndryshme në pyetjet e njëjta, përceptim dhe analizë të konstitutit në aspekte të ndryshme, dhe kështu duke përfshirë qëndrimet e tyre, kritikën gjatë realizimit të procedurës kontestuese, arrihet hulumtim, studim i lëndës kontestuese me çka vërtetohet e vërteta ekzistuese dhe bëhet sjellja e vendimit meritor.

Me këtë bëhet edhe barazim i subjekteve në aspektin juridik me çka arrihet mbrojtje objektive, efektive e të drejtave të tyre. Nëpërmjet këtij parimi shkohet drejt qëllimit që palëve t'u sigurohet barazi subjektive në proces gjatë mbrojtjes së të drejtave të tyre, si dhe gjithashtu gjykata gjatë realizimit të kontestit të kuptojë të vërtetën me çka jep vendim meritor dhe ligjor.

Gjatë realizimit të parimit të dëgjimit të palëve vjen në shprehje edhe dëgjimi i palëve si dëshmi pasi që në mosmarrëveshjet që dalin mes tyre dhe gjatë seancës në të cilën ato përballen njëra me tjetrën në lidhje me kontestin e tyre do t'i shpalosin në momentdisa të dhëna të cilat nuk i kanë të shprehura në padi gjatë paraqitjes së fakteve dhe provave, shprehje të cilat gjykata do t'i konsiderojë si dëshmi për vërtetimin e të vërtetës.

Dëgjimi i palëve është mjet provues esenca e të cilit është e njëjtë me esencën e dëshmitarëve si mjet provues. Dëgjimi i palëve si mjet provues do të thotë se palët dëgjojnë dëshmitarë në procesin kontestimor të tyre.

⁹Janevski, Arsen, Kamilofska, Zoroska, Tatjana, "E drejta e Procedurës civile", fq. 77, Shkup, 2009

Mirëpo, për shkak të pozitës specifike faktike dhe juridike të palëve, ndaj dëshmitarëve, dëgjimi i palëve normohet si formë e veçantë e provës. Palët janë burimi kryesor dhe i sigurt i dijenisë me faktet relevante të çështjes juridike. Ato zakonisht, me së miri e dijnë gjendjen faktike në të cilën i mbështesin pretendimet e tyre. Gjithashtu më së miri u kujtohen ngjarjet, dukuritë, gjendjet e sendeve apo të njerëzve etj, të rëndësishme për themelimin dhe zhvillimin e një marrëdhënieje civilw. Mirëpo ky mjet provues nuk mund të jetë i besueshëm, sepse palët nuk i tregojnë drejt faktet, veçse në mënyrën e cila i përgjigjet interesit të tyre që ta fitojnë gjykimin.¹⁰

Parimi i dëgjimit të pjesëmarrësve në procedurën jashtëkontestimore nuk është njëlloj sikurse parimi i dëgjimit reciprok të palëve në procedurën kontestimore. Në procedurën jashtëkontestimore, deklaratat mund të jepen edhe pa praninë e personave të tjerë të interesuar.¹¹ Dëgjimi i pjesëmarrësve në procedure jashtëkontestimore është autorizim dhe jo detyrim i gjykatës. Gjykata mund ta dëgjojë pjesëmarrësin me gojë ose me shkrim, në seancë, nëse mbahet seancë, ose jashtë saj. Gjykata nuk mund t'i detyrojë pjesëmarrësit që t'i shprehin qëndrimet apo porozimet e veta. Mungesa e pjesëmarrësve, të cilët janë thirrur sipas rregullit, nuk përbën pengesë për mbajtjen e seancës dhe për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme nga ana e gjykatës.¹²

1.2.4 Parimi i konstatimit të së vërtetës dhe parimi i vlerësimit të lirë të provave

Parimi i vlerësimit të lirë të provave- Ky parim është i lidhur drejtpërdrejt me parimin e konstatimit të sëvërtetës materiale në procedurën civile. Parimi i vlerësimit të lirë tëprovave nënkupton që gjykata vlerëson provat e paraqitura në pajtimme logjikën e saj dhe analizën psikologjike, në bazë të ligjshmërisë sëmendimit njerëzor dhe në bazë të përvojave. Esenca e këtij parimi qëndron në faktin se gjykata duhet që në mënyrë të saktë dhe të drejtë t'i vërtetojë të gjitha faktet që janë me rëndësi për sjelljen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Me ndërmarrjen e veprimeve të caktuara nga ana e subjekteve proceduralë qëllimet e tyre janë tëcaktuara dhe interesi i tyre është zgjidhja e çështjessë parashtruar, dhe nga pjesëmarrësit në procedurë varet se si do t'i ndërmarrin veprimet e tyre.

¹⁰ Janevski, Arsen, Kamilovska, Zoroska, Tatjana, "E drejta e Procedurës civile", fq. 77, Shkup, 2009

¹¹ Neni 9, paragrafi 3 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹² Neni 10, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

Veprimet procedurale që i ndërmerr çdonjëri nga pjesëmarrësit në procedurë i qartësojnë qëllimet subjektive të tyre: çdonjëri nga pjesëmarrësit me anë të veprimeve që ndërmerr synon drejt asaj që vendimi gjyqësor të jetë i volitshëm për të dhe ajo të ketë sukses në procedurë. Veprimet ofenzive të pjesëmarrësit në procedurë janë ato veprime që ndërmerrën me qëllim të realizimit të ndonjë rezultati të pavarur procedural, pra arrijnë e mbrojtjes juridike me përmbajtje tëcaktuar. Në varësi nga lloji i mbrojtjes juridike, qëllimi i veprimeve ofenzive është që të arrihet ndryshimi i ndonjë situatë juridike ekzistuese, ose që të sanksionohet e njëjta.

Në procedure jashtëkontestimore konstatimi i të vërtetës i kalon kufijtë e parimit të shqyrtimit. Për shkak të mbizotërimit të interesit publik, gjykata është e autorizuar t'i konstatojë dhe faktet që nuk janë paraqitur nga pjesëmarrësit, si dhe faktet që nuk janë të kontestueshme mes pjesëmarrësve, nëse janë të rëndësishme për sjelljen e vendimit.¹³

Kërkimi i së vërtetës në procedurë jashtëkontestimore është i lidhur me parimin e vlerësimit të lirë të provave. Gjkata vendos sipas bindjes së saj, cilat fakte do t'i marrë si provuese, bazuar në një vlerësim të ndërgjegjshëm e të kujdesshëm të secilës provë veç e veç dhe të gjithë provave së bashku, si dhe në bazë të rezultateve të procedurës.¹⁴ Megjithatë në disa procedura për rregullimin e marrëdhënieve familjare, duhet të paraqiten prova të cilat janë të përcaktuara me ligj.

1.2.5 Parimi i zhvillimit të gjykimit gojarisht dhe me shkrim

Këto parime janë parime procedurale lidhur me formën në të cilën ndërmerren veprimet procedurale në procedurë. Parimi i zhvillimit të gjykimit gojarisht kërkon që të gjitha veprimet procedurale të ndërmerren gojarisht, ndërsa parimi i zhvillimit të gjykimit me shkrim mbron rëndësinë e çfarëdo veprimi në procedurë, i cili nuk është ndërmarrë në mënyrë të shkruar. Sipas parimit të zhvillimit të gjykimit gojarisht, të gjitha veprimet në procedurë duhet të ndërmerren me gojë. Ndërsa sipas parimit të zhvillimit të gjykimit me shkrim, veprimet në procedurë duhet të ndërmerren në formë të shkruar.

Sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, propozimet dhe deklaratat në procedurën jashtëkontestimore jepen në formë të shkruar ose me gojë në procesverbal përpara gjykatës.

¹³Neni 8, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹⁴Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 24

Gjykata i merr parasysh dhe i vlerëson propozimet me shkrim dhe me gojë, të dhëna nga gjithë pjesëmarrësit në procedurë.¹⁵

1.2.6 Parimi i pa ndërmjetësisë

Ky parim paraqet metodë pune për grumbullimin dhe ekzaminimin e materialit procedural. Parimi i pandërmjetësisë kërkon që: gjykata me shqisat e veta të vërejë natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese; që gjykata para së cilës nxirret materiali procedural të jetë po ajo gjykatë e cila do të vendosë edhe për fuqinë provuese të mjeteve provuese; që po ajo gjykatë të sjell vendimin menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit.¹⁶

Sipas këtij parimi është e nevojshme që ndërmjet gjykatës dhe mjeteve provuese, respektivisht burimeve të informacionit të mos ketë ndërmjetësues, respektivisht gjykata me anë të shqisave të veta të vërejë natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese. E njëjta gjykatë, e cila kryenperceptimin e materialit procedural duhet të vendosë edhe për fuqinë provuese të mjeteve provuese; dhe të sjellë vendimin menjëherë pas përfundimit të seancës në të cilën është mbledhur materiali procedural.

Për dallim nga procedura kontestimore, ku ky parim është shumë i rëndësishëm, në procedurën jashtëkontestimore nuk është dhe aq prezent. Kjo për arsye se në procedurë jashtëkontestimore jo gjithmonë mbahet seancë për të argumentuar me gojë dhe gjithashtu të provuarit nuk ka karakter aq formal sa në procedurë kontestimore, prandaj nuk insistohet për perceptimin e pandërmjetëm të materialit provues nga ana e gjykatës së njëjtë.¹⁷

1.2.7 Parimi i publicitetit

Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë është paraparë se shqyrtimi përpara gjykatave dhe shpallja e vendimeve janë publike. Publiku mund të përjashtohet vetëm në raste të përcaktuara me ligj.¹⁸ Ky parim supozon mundësi për pjesëmarrje të papenguar në shqyrtim

¹⁵ Neni 9, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore.

¹⁶ Markoviç. M , Gradansko procesno pravo, Beograd 1957,

¹⁷ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtoro – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 26

¹⁸ Neni 102 i Kushtetutës së RMV-së

përpara gjykatëstë një numri të pakufizuar të personave të cilët paraprakisht nuk janë të caktuar. Publiciteti mund të përjashtohet gjatë zhvillimit të procedurës ose në një pjesë të caktuar e saj, por edhe atëherë shpallja e gjykimit është publike.¹⁹

Përjashtim nga ky parim bëjnë procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve dhe gjendjeve personale dhe familjare, ku publiku është i përjashtuar.²⁰

1.2.8 Parimi i kujdesit të veçantë për personat që nuk janë në gjendje të kujdesen vetë për të drejtat dhe interesat e tyre

Parimi i kujdesit të veçantë për personat të cilët nuk janë në gjendje vetë të kujdesen për të drejtat e tyre është një parim specifik i procedurës jashtëkontestimore. Në procedurën jashtëkontestimore, gjykata sipas detyrës zyrtare është veçanërisht e obliguar të kujdeset dhe të ndërmarrë masa për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të mitur, të cilët nuk janë në gjendje vetë të kujdesen për të drejtat dhe interesat e tyre.²¹

Si arsye për ekzistimin e këtij parimi është mosha e mitur e pjesëmarrësve dhe pamundësia e pjesëmarrësve të tjerë të kujdesen për çështjet e tyre. Për shembull, sëmundja shpirtërore e pjesëmarrësit, mungesa e pjesëmarrësit nga vendi i zhvillimit të procesit, apo rastet kur kompetencën për të vendosur e ka organ i huaj.

Në raste të këtilla, kujdesi i gjykatës shfaqet në obligimin për shpallje të informacionit. Përveç kësaj, obligimin që buron nga ky parim, gjykata e realizon edhe me emërim të përfaqësuesit të përkohshëm gjegjësisht kujdestarit, si dhe me shënim të kësaj rrethane në librin amë, me regjistrim dhe vlerësim të pronës, ruajtje të mjeteve si masë e sigurisë, me njoftimine organit të kujdestarisë, etj.

Kur në procedurë jashtëkontestimore vendoset për të drejtat dhe interesat e një të mituri apo të personave të tjerë që janë nën kujdes të veçantë të shtetit, gjykata është e detyruar të njoftojë Qendrën për punë sociale për iniciimin e procedurës, ta ftojë në seancë dhe t'i dorëzojë të gjitha shkresat.²² Qendra për punë sociale që merr pjesë në procedurë edhe në rastet kur nuk është e autorizuar ta iniciojë procedurën, është e autorizuar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e

¹⁹ Janevski Arsen, Dostavljanje po zakonu o parničnom postipku, Republike Makedonije, Pravi život, Broj 12, Beograd, 2006.

²⁰ Neni 11 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

²¹ Neni 4, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

²² Neni 4, paragrafi 3 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të miturit dhe personave të tjerë që janë nën kujdes të veçantë të shtetit, dhe sidomos të paraqesë fakte që pjesëmarrësit nuk i kanë paraqitur, të propozojë paraqitjen e provave dhe të deklarojë mjete juridike.²³

1.2.9 Parimi i efikasitetit

Parimi i efikasitetit është një parim shumë i rëndësishëm dhe specifik i procedurës jashtëkontestimore. Mbrojtja juridike që jepet në procedurës jashtëkontestimore ka kuptim vetëm nëse jepet shpejt dhe në kohë. Prandaj, ligji parashikon detyrimin e gjykatës jashtëkontestimore që të kujdeset që sa më shpejt t'i vërtetojë dhe sigurojë të drejtat e pjesëmarrësve në procedurë.²⁴ Në procedura të veçanta jashtëkontestimore ky parim është akoma më tepër i theksuar për shkak se ligji parashikon shprehimisht se procedura është urgjente. Gjithsesi, parimi i shpejtësisë dhe efikasitetit nuk duhet ta vë në pikëpyetje kualitetin e mbrojtjes juridike dhe as të bie ndesh me parimet e tjera të procedurës jashtëkontestimore.

1.2.10 Parimi i interesit më të lartë të fëmijës

Çështja e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës është shumë e rëndësishme në teorinë dhe praktikën e çështjeve familjare. Kjo konsideratë parësore e interesit më të lartë të fëmijës është kryesisht detyrë e prindërve, si edhe e organeve kompetente dhe gjykatave, të cilat në të gjitha vendimet dhe veprimtaritë e tyre duhet të kenë në qendër pikërisht këtë interes.

Interesi më i lartë i fëmijës u prezantua për herë të parë nga Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve, sipas së cilës “në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”.²⁵

²³ Neni 5 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

²⁴ Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

²⁵ Neni 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989)

Ky parim, u inkorporua në legjislacionet e gjithë shteteve anëtare të Konventës, midis të cilave, edhe Maqedonia e Veriut.

Neni 42 i Kushtetutës së RMV-së u garanton fëmijëve të drejtën e mbrojtjessë vecantë nga shteti. Në këtë kuadër institucionet publike dhe private të mbrojtjes sociale, gjykatat dhe autoriteteve administrative në vendimet e tyre duhet gjithmonë, në të gjitha çështjet ku janë të përfshirë të miturit, të udhëhiqen nga interesi më i lartë i fëmijës.

KAPITULLI II

PROCEDURAJASHTËKONTESTIMORE PËR DHËNIEN E LEJES PËR LIDHJEN E MARTESËS

2.1 Kushtet thelbësore për lidhjen e martesës dhe pengesat martesore

Institucioni i martesës haset në të gjitha shoqëritë njerëzore të botës së hershme dhe asaj moderne, përbën një nga shtyllat mbi të cilat këto shoqëri kanë ngritur tërë ngrehinën e tyre dhe ka qenë objekti i studimit dhe i përkufizimit nga shumë shkolla fetare, filozofike, sociologjike, psikologjike, kulturore etj. Në shumë kultura është parë si një kusht i domosdoshëm për përjetësimin e gjinisë njerëzore, si një vatër e domosdoshme për rritjen dhe zhvillimin e njeriut si individ dhe person dhe në këtë kuadër edhe si bërthama e shumë shoqërive në anë të ndryshme të globit. Në mjaft fe që mbizotërojnë në planetin tonë përbën një nga çështjet më kryesore dhe të shenjta, shpeshherë tabu dhe është mbrojtur nga ana e tyre me tërë arsenalin e argumenteve teologjike dhe filozofike, në mënyrë që të ruajë tërë rëndësinë dhe shenjtërinë e saj, duke u prezervuar edhe nga legjislacionet përkatëse në ato vende, ku këto fe kanë predominuar gjatë përhapjes së tyre.

Në legjislacionin e RMV-së, martesa përkufizohet si bashkësi jetese e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë.²⁶

Për lidhjen e martesës nevojitet ekzistenca e disa kushteve thelbësore, pa të cilat martesa nuk mund të lidhet, ndërsa martesa e lidhur në mungesën e këtyre kushteve është absolutisht e pavlefshme. Ndërsa pengesat martesore janë rrethana apo fakte të përcaktuara me ligj, të cilat nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës. Pra këto janë elemente me ngarkesë negative që përcaktohen me ligj, të cilat nuk duhet të ekzistojnë sepse pengojnë lidhjen e martesës.

Kushtet thelbësore për lidhjen e martesës janë të përgjithshme, ndërsa pengesat martesore janë konkrete. Ato lidhen me një person të caktuar në një rast konkret.

Kushtet thelbësore për lidhjen e martesës janë²⁷:

- 1) gjinitë e kundërta;

²⁶ Neni 6 i Ligjit për Familjen të RMV-së (Gazeta Zyrtare nr.80/1992) – me ndryshime dhe plotësime

²⁷ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 114-116

- 2) përputhja e vullneteve të bashkëshortëve të ardhshëm për lidhjen e martesës dhe
- 3) forma e lidhjes së martesës (lidhja e martesës përpara organit kompetent).

Gjinitë e kundërta – Siç duket dhe nga përkufizimi i martesës (neni 6 i Ligjit për Familjen), në RMV lejohet martesa vetëm midis dy personave të gjinive të kundërta, pra martesa midis personave të të njëjtës gjini është e ndaluar. Gjinitë e kundërta përbëjnë komponentin biologjik, kulturor dhe civilizues të një martese. Shikuar historikisht martesa ka qenë një privilegj i gruas dhe i burrit, pra i dy personave të gjinive të kundërta. Qëllimi natyror i martesës ka qenë krijimi dhe mirrëritja e fëmijëve. Mungesa e gjinive të kundërta paraqet pengesë absolute për lidhjen e një martese, kjo sepse martesa është bashkësi jetësore e një burri dhe një gruaje dhe si e tillë është përkufizuar në legjislacionin familjartë shumë vendeve si Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.²⁸

Lidhja e martesës mes dy personave me gjini të njëjtë nuk është e lejueshme ngase kjo është në kundërshtim me qëllimin natyror të martesës si bashkësi e vazhdueshme e dy personave me gjini të kundërta. Mirëpo ka shumë raste në praktikë ku martesa është lidhur mes personave me seks të njëjta (homoseksualë), sidomos në kohët e lashta kur shkuesi ndërmjetësonte lidhjen e martesës ndërsa dhëndri dhe nusja nuk takoheshin dhe nuk njiheshin deri në natën e martesës. Kështu që bashkëshortët nuk kanë pasur mundësi që të vërtetonin gjininë e tjetrit. Është çështje e ekspertizës mjeko-ligjore për të vërtetuar nëse njëri bashkëshort apo të dy bashkëshortët kanë organe seksuale të njëjta. Dhe në qoftë se vërtetohet se të dy bashkëshortët janë të së njëjtës gjini atëherë martesa do të jetë absolutisht nule. Për vërtetimin e llojit të organit nuk bëhet kontroll mjekësor i organeve seksuale të bashkëshortëve me rastin e martesës, por kjo bëhet në mënyrë vizuale me rastin e lindjes dhe regjistrohet në librat amzë të të lindurve.²⁹

Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm – që martesa e lidhur të jetë e vlefshme, e rëndësishme është që deklarimi të bëhet në mënyrën e parashikuar me ligj dhe pa kushtëzime. Që bashkëshortët e ardhshëm të deklarojnë pëlqimin e tyre se martesën e lidhin me vullnetin e lirë të tyre. Martesa nuk do të jetë e vlefshme në qoftë se bashkëshortët nuk kanë deklaruar pëlqimin e tyre me vullnetin e lirë të tyre por me anë të shtrëngimit, lajthimit apo kërcënimit, apo në mënyrë tjetër, dmth ka munguar vullneti i lirë i brendshëm i bashkëshortëve të ardhshëm.³⁰ Deklarimi i vullnetit të lirë të palëve bëhet me shkrim apo me gojë. Deklarimi me gojë shënohet në

²⁸ Podvorica, Hamdi "E drejta familjare", Prishtinë, 2005, fq. 73

²⁹ Po aty, fq. 74

³⁰ Po aty, fq. 67

procesverbal. Deklarimi bëhet në të njëjtën kohë dhe ka rëndësi në aspektin e sigurisë juridike nga shkak se diferenca eventuale kohore mundëson hapësirë për tërheqjen e pëlqimit të dhënë kohë më parë nga njëri bashkëshort. E rëndësishme është që deklarimi të bëhet në mënyrën e parashikuar në ligj, pa kushtëzime.³¹

Për të qenë një martesë e vlefshme, vullneti i shprehur duhet të ketë cilësitë e caktuara

- a) të jetë real e jo simulativ (që do të thotë të jetë i deklaruar për të arritur ndonjë qëllim të caktuar e jo për lidhjen e martesës);
- b) të jetë serioz e jo i shprehur për shaka;
- c) dy deklarata duhet të jepen në të njëjtën kohë suksesivisht në çastin e lidhjes së martesës.

Secili bashkëshort vullnetin e vet duhet ta shpreh personalisht dhe veç e veç e kjo nënkupton prezencën e bashkëshortëve. Deklaratën e jep një herë njëri pastaj tjetri bashkëshort. Deklarata duhet të jetë e përputhshme, e shprehur shprehimisht në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë në aspektin e qëllimit. Dhe deklarimi duhet të bëhet në mënyrën e përcaktuar me ligj, pa kushtëzime.³²

Lidhja e martesës përpara organit kompetent – deklarimi i vullnetit të lirë për lidhjen e martesës së personave me gjini të kundërt përmban në vetvete dy komponentë:

- a) vullneti të jetë i shprehur para organit kompetent për lidhjen e martesës dhe
- b) në mënyrën e parashikuar me ligj.

Martesa lidhet përpara nëpunësit të gjendjes civile. Nuk mund të jetë e vlefshme martesa në qoftë se nuk është lidhur përpara organit kompetent, sepse në këtë mënyrë nuk plotësohet kushti thelbësor i saj i parashikuar me ligj. Edhe komponenti i dytë, mënyra e parashikuar në ligj është kusht i domosdoshëm për vlefshmërinë e një martese. Me formën e lidhjes së martesës nënkuptojmë edhe prezencën e dy bashkëshortëve, dy dëshmitarëve dhe nëpunësit të gjendjes civile. Në qoftë se në rastin e lidhjes së martesës nuk kanë qenë të plotësuar ndonjëri nga kushtet, atëherë konsiderohet se një martesë e tillë as që ka ekzistuar. Ndërsa martesa që nuk është e lidhur sipas asaj që është parashikuar me ligj është nule. Pra, që një martesë të jetë e vlefshme duhet që lidhja e saj të bëhet para organeve kompetente për lidhjen e martesës në mënyrën e parashikuar me ligj.³³

³¹Podvorica Hamdi, "E drejta familjare", Prishtinë, 2005, fq. 72

³² Po aty, fq. 73

³³ Po aty, fq. 75

Pengesat për lidhjen e martesës—janë fakte apo rrethana të përcaktuara me ligj, të cilat nuk duhet të ekzistojnë në çastin e lidhjes së martesës. Në rastin kur martesa lidhet me ekzistencën e këtyre rrethanave, ajo nuk do të jetë e plotfuqishme dhe mund të shpallet e pavlefshme. Deri në pavlefshëri të martesës mundet të vijë edhe nëse martesa nuk është lidhur për shkak të jetës së përbashkët, por me qëllim tjetër, për shembull, për të përfituar pension familjar, pasuri më të madhe, etj., veçanërisht nëse martesa është lidhur me person të moshuar ose të pa aftë. Martesat e këtilla të lidhura me qëllim tjetër dhe jo për jetë të përbashkët quhen martesa fiktive. Deri tek shkatërrimi i kurorës mundet të vihet edhe nëse para lidhjes së saj ka ekzistuar mungesë në autorizimin me të cilin njëri nga bashkëshortët ka qenë i përfaqësuar.

Sipas legjislacionit tonë pengesat martesore janë³⁴:

- 1) mituria,
- 2) martesa ekzistuese,
- 3) forma e manifestuar e sëmundjes psikike, paaftësia për të gjykuar dhe zhvillimi mendor (psikik) i prapambetur
- 4) gjinia (e gjakut, e adoptimit, e krushqisë) dhe
- 5) mangësitë në shprehjen e vullnetit për lidhjen e martesës.

Martesa është një akt shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut dhe që kërkon detyrimisht një pjekuri fizike dhe intelektuale të mjaftueshme për të marrë përsipër detyra dhe të drejta dhe përgjegjësi emocionalisht dhe realisht.³⁵

2.1.1 Mituria si pengesë për lidhjen e martesës

Mituria është një pengesë serioze për lidhjen e martesës. Martesë, sipas ligjit tonë mund të lidh vetëm personi i cili në çastin e lidhjes së martesës ka mbushur 18 vjet. Mbushja e 18 vjetëve konsiderohet si moshë e pjekurisë për të dyja gjinitë. Personi i cili nuk ka mbushur 18 vjet nuk mund të lidh martesë³⁶. Nëse lidhet martesë e tillë, ajo mund të shpallet e pavlefshme. Pjekuria martesore nënkupton arritjen e një shkalle të caktuar të pjekurisë psiko-fizike të personit, që

³⁴ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 117-121

³⁵ Podvorica Hamdi, "E drejta familjare", Prishtinë, 2005, fq.95

³⁶ Neni 16, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen i RMV-së

garanton se ai mund t'i kuptojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë. Ndalesa e martesave të personave të mitur parashikohet në të gjitha legjislacionet e vendeve evropiane.³⁷

Megjithatë për shkaqe të arsyeshme, gjykata kompetente mund të lejojë lidhjen e martesës të një personi që ka mbushur 16 vjet. Kjo do të lejohet, nëse gjykata në procedurë jashtëkontestimore vërteton se personi ka arritur pjekurinë e nevojshme për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë, me mendim paraprak të institucionit shëndetësor dhe ndihmë profesionale të Qendrës për punë sociale.³⁸ Me dhënien e lejes për lidhjen e martesës, mënjanohet pasoja e miturisë si pengesë martesore. Ndërsa, i mituri fiton zotësi të plotë për të vepruar nga çasti i lidhjes së martesës.

2.1.2 Martesa ekzistuese si pengesë për lidhjen e martesës

Martesa ekzistuese si pengesë martesore bazohet në parimin e monogamisë, që është një parim i pranuar nga të gjitha legjislacionet familjare bashkëkohore. Edhe legjislacioni ynë parashikon se “personi nuk mund të lidhë martesë të re deri sa martesë e mëparshme nuk ndërpritet”.³⁹ Pra, bashkëshortët të cilët janë në lidhje martesore nuk mundin të lidhin martesë të re deri sa lidhja martesore ekzistuese nuk ndërpritet: me vdekjen e njërit prej tyre, me shkurorëzim, me deklarimin e njërit prej tyre si të vdekur apo me shpalljen të pavlefshmetë martesës. Në rast të kundërt, martesë do të shpallet e pavlefshme dhe personi që nuk e ka respektuar këtë pengesë martesore do të mbajë përgjegjësi penale për veprën penale martesë e dyfishtë (bigami).

2.1.3 Forma e manifestuar e sëmundjes psikike, paaftësia për të gjykuar dhe zhvillimi mendor i prapambetur si pengesë martesore

Forma e manifestuar e sëmundjes psikike, paaftësia për të gjykuar dhe zhvillimi mendor (psikik) i prapambetur përbëjnë pengesë martesore për arsye se bëhet fjalë për gjendje të caktuara në të cilat personat nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e martesës dhe të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga martesë. Këto forma të sëmundjeve psikike ligjvënësi i ndan në dy grupe.

³⁷ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 101

³⁸ Neni 16, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen i RMV-së

³⁹ Neni 17 i Ligjit për Familjen

Në grupin e parë, nuk mund të lidhin martesë personat të cilët për shkak të formës së manifestuar të smundjeve psikike me prezencë të simptomave psikotike dhe me shenja reziduale të sëmundjes, nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e martesës dhe detyrimet që dalin nga ajo, dhe të cilët në të njëjtën kohë janë të paaftë për të gjykuar.⁴⁰ Gjithashtu, nuk mund të lidhin martesë dhe personat që kanë ngecje (prapambetje) në zhvillimin psikik (mendor) dhe bëjnë pjesë në grupin e personave me prapambetje më të rëndë dhe shumë të rëndë me IQ nën 36.⁴¹*

Në grupin e dytë bëjnë pjesë persona me pengesa më të lehta në zhvillimin mendor, të cilët në kushte të caktuara mund të lidhin martesë.⁴² Personat me pengesa të moderuara në zhvillimin mendor dhe personat që kanë sëmundje të rënda, të trashëgueshme në familje mund të lidhin martesë në bazë të mendimit paraprak të lëshuar nga Enti për shëndet mendor të fëmijëve dhe të rinjve në Shkup ose tjetër institut përkatës i cili merret me studime gjenetike.⁴³

2.1.4 Gjinia si pengesë për lidhjen e martesës

Gjinia si lidhje e njohur me ligj midis dy a më shumë personave, nga e cila rrjedhin të drejta dhe detyrime të ndërsjella, përbën një nga pengesat martesore më të përhapura në legjislacionet familjare bashkëkohore. Gjinia është pengesë martesore, qoftë ajo: gjini e gjakut, gjini e adoptimit apo gjini e krushqisë.

Gjinia e gjakut – është lidhje natyrore dhe biologjike midis dy ose më shumë personash, të cilët rrjedhin nga njëri-tjetri ose nga një paraardhës i përbashkët. Ajo përbën pengesë martesore për arsye se nga martesa e lidhur midis personave në gjini gjaku lindin fëmijë të cilët mund të ketë të meta fizike ose psikike. Gjinia e gjakut është pengesë martese qëshkakton nulitet absolut të martesës. Gjinia e gjakut është pengesë martesore, në vijë të drejtë pa kufizime, ndërsa në vijë të tërthortë gjer në shkallën e katërt. Kështu sipas legjislacionit tonë, nuk mund të lidhin martesë me njëri-tjetrin personat që janë në gjini të gjakut në vijë të drejtë (gjyshi, gjyshja, nëna, babai,

⁴⁰ Neni 18, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

⁴¹ Neni 18, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

⁴² Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 120

⁴³ Neni 18, paragrafi 3 i Ligjit për Familjen

nipërit dhe mbestat) si dhe vëllezërit dhe motrat, vëllai dhe motra nga babai, gjegjësisht nga nëna, xhaxhai dhe fëmija e vëllait (mbesa), daja dhe fëmijae motrës (mbesa), halla dhe fëmijae vëllait (nipi), teza dhe fëmijae motrës (nipi), si dhe kushërinjtë e parë.⁴⁴

Gjinia e adoptimit – Si adoptimi i plotë, ashtu dhe ai jo i plotë është pengesë martesore. Për dallim nga gjinia e gjakut, adoptimi krijohet në mënyrë artificiale, në rrugë ligjore. Është pengesë martesore sepse me themelimin e adoptimit, midis adoptuesit dhe të adoptuarit krijohen lidhje si ato që ekzistojnë midis prindërve dhe fëmijëve. Adoptimi i plotë është pengesë martesore në vijë të drejtëpakufi, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt. Adoptimi i plotë është pengesë martesore që shkakton nulitet absolut, pengesë e përhershme dhe epaevitueshme. Adoptimi jo i plotë është pengesë martesore në shkallë të parë, dmth., adoptuesinga njëra anë dhe i adoptuari me të paslindurit e tij nga ana tjetër. Adoptimi jo i plotë është pengesë që shkakton nulitet absolut, por mund të jetë pengesë e përkohshme dhe evitueshme, sepse adoptimi jo i plotë mund të shkeputet për shkaqe të arsyeshme dhe të lejohet lidhjen e martesës.

Gjinia e krushqisë – është lidhje juridike midis njërit bashkëshort dhe të afërmeve të gjakut të bashkëshortit tjetër. Është pengesë martesore që ka për qëllim ruajtjen e marrëdhënieve të mira në familje dhe sigurimin e respektit të ndërsjellë midis njërit bashkëshort dhe të afërmeve të bashkëshortit tjetër.⁴⁵ Legjislacioni ynë parashikon se nuk mund të lidhin martesë: vjehri dhe e reja, vjehrra dhe dhëndri, njerku dhe thjeshtira, njerka dhe thjeshtiri, pavarësisht faktit nëse martesa në bazë të së cilës është krijuar gjinia e krushqisë, ka pushuar.⁴⁶ Gjinia e krushqisë është pengesë martesore që shkakton nulitet absolut, por është pengesë e evitueshme, sepse gjykatakompetente për shkaqe të arsyeshme, mund të lejojë lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie.

2.1.5 Mangësitë në shprehjen e vullnetit si pengesë për lidhjen e martesës

⁴⁴ Neni 20, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

⁴⁵ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 104

⁴⁶ Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen.

Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm është kusht për lidhjen e një martese të vlefshme. Mangësitë në shprehjen e vullnetit përbëjnë pengesë martesore në rastin kur ekziston mospërputhje e vullnetit të shprehur me vullnetin e brendshëm për lidhjen e martesës. Ligji për Familjen parashikon se martesa nuk është e plotfuqishme kur pëlqimi për lidhjen e saj është dhënë nën shtrëngim apo lajthim.⁴⁷

Shtrëngimi është veprim i palejuar i një personi i cili me dhunë ose kërcënim detyron një person tjetër të shprehë një vullnet të caktuar. Është pengesë martesore sepse sjell mospërputhje midis vullnetit të vërtetë dhe vullnetit të shprehur për lidhjen e martesës.

Lajthimi është parafytyrim i gabuar për rrethana të caktuara që janë relevante për krijimin e marrëdhënies juridike, pra për lidhjen e martesës. Për dallim nga shtrëngimi, lajthimi është mospërputhje e pandërgjegjshme e vullnetit të brendshëm me vullnetin e shprehur. Lajthimi mund të shfaqet si: *lajthim për personin fizik* – kur mendohet se lidhet martesë me një person, por në fakt lidhet martesë me një person tjetër; *lajthim për personin civil* – kur personi me të cilin lidhet martesa prezantohet si dikush tjetër (p.sh. mendojmë se po lidhim martesë me një kirurg, por në fakt po lidhim martesë me një mekanik) dhe *lajthim për karakteristika të rëndësishme të bashkëshortit* – kur ekzistojnë rrethana apo karakteristika të njërit bashkëshort, të cilat po t'i kishte ditur bashkëshorti tjetër në çastin e lidhjes së martesës, nuk do ta kishte lidhur martesën (p.sh. sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme, sjellje të paligjshme, shtatzëni, etj.).⁴⁸

2. 2 Instituti i emancipimit

Emancipimi është institut në bazë të të cilit i lejohet martesa të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç. Të miturit që ka mbushur moshën 16 vjeç mund t'i lejohet të lidhë martesë, nëse gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore vërteton se ka arritur pjekurinë trupore dhe mendore që nevojitet për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, me mendim paraprak nga institucioni shëndetësor dhe ndihmë eksperte nga Qendra për punë sociale.⁴⁹ Martesa është një akt shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut dhe që kërkon detyrimisht

⁴⁷ Neni 19 i Ligjit për Familjen

⁴⁸ Dejan Mlickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 122

⁴⁹ Neni 16, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen dhe Neni 98 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

një pjekuri fizike dhe intelektuale (psikike) të mjaftueshme për të marrë përsipër detyra, të drejta dhe përgjegjësi, jo vetëm dhe thjesht emocionalisht, por, në thelb, realisht.⁵⁰ Dhënia e lejes për lidhjen e martesës bëhet në procedurë e veçantë jashtëkontestimore, në të cilën gjykata lejon lidhjen e martesës nga i mituri i moshës 16 deri në 18 vjeç, kur ekzistojnë rrethana që e justifikojnë lidhjen e martesës. Në këtë procedurë, propozimin për dhënien e lejes për lidhjen e martesës e parashtron i mituri, ndërsa në rastin kur të dy personat që duan të lidhin martesë janë të mitur, ata parashtojnë propozim të përbashkët. Në aktvendimin me të cilin të miturit i lejohej lidhja e martesës, deklarohet personi me të cilin i lejohej të lidhë martesë dhe se martesë mund të lidhet vetëm pas plotfuqishmërisë së vendimit. Megjithatë aktvendimi ka karakter konstitutiv sepse shërben si bazë për lidhjen e martesës, i mituri do të fitojë zotësinë e plotë për të vepruar vetëm nëse martesë lidhet, dhe vetëm nëse lidhet me personin e deklaruar në aktvendim. Kur vërtetohet se një person ka arritur pjekurinë trupore dhe mendore për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga lidhja e martesës, është e justifikuar që ta fitojë zotësinë e veprimit me lidhjen e martesës, para moshës 18 vjeç.⁵¹ Kjo do të thotë se zotësia e veprimit e fituar në këtë mënyrë, nëpërmjet emancipimit, nuk do të humbasë edhe nëse martesë ndërpritet, pra i mituri do të vazhdojë të ketë zotësi të plotë për të vepruar.

2.3 Procedura jashtëkontestimore për dhënien e lejes për lidhjen e martesës

Sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, procedurajashtëkontestimoreinicihet me propozimtëpersonittëautorizuar dhëngaorganiicaktuar me këtëligjose me ligjtjetër.Gjithashtu, procedurajashtëkontestimoreinicihetngagjykatasipasdetyrëszyrtarenërastetkurkjoështëpërcaktuar me këtëligjose me ligjtjetër.⁵²

Pjesëmarrësnëprocedurëjashtëkontestimoreështëpersonimetëcilinnëmënyrëtdrejtëpërdrejtë ka tëbëjëvendimiigjykatës, iciliinteresin e vetjuridik e realizonpërmeskërkesësquëdrejtongjykatëspërtëmarrëvendim, sidhepersonipërkatësishtorgani, e drejta e tëcilinëpjesëmarrjeështë e përcaktuar me ligj.⁵³

⁵⁰ Albana Metaj-Stojanova “Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile” në “Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja”, Tetovë, 2022, fq. 171-172

⁵¹ Nenet 93-105 të Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore të RMV-së

⁵² Neni 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁵³ Neni 3 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

Propozuesi paskëtit ligji është personi, përkatësisht organi me propozimin e të cilit është ngritur procedura, ndërsa kundërshtari i propozuesit është personi i ndaj të cilit realizohet e drejta ose interes i juridik i propozuesit.

Pjesëmarrësit në procedurë, veprimet e ndërmarrin personalisht ose përmes të autorizuarit, në pajtim me Ligjin për procedurë kontestimore. Në procedurë nëpërmjet ligjimit e marrëdhënieve dhe gjendjeve personale dhe familjare, publiku përjashtohet.

Propozimi për ngritjen e procedurës jashtë kontestimore mund të tërhiqet deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë. Propozimi i paraqitur ngamëte për persona,

mund të tërhiqet nëse ekziston pajtimi i tyre,

nëse nuk është përcaktuar ndryshe. Propozimi mund të tërhiqet dhe më vonë,

deri sa vendimi nuk është bërë i plotfuqishëm, nëse me këtë nuk cenohet drejtat e pjesëmarrësve të tjerë për të cilët ka të bëjë vendimi, ose nëse pjesëmarrësit e tjerë për këtë pajtohen. Nëse propozimi është tërhequr pas plotfuqishmërisë së vendimit të shkallës së parë, gjyqi i shkallës së parë do ta tërheqë vendimin.

Do të konsiderohet se propozimi është tërhequr, kur propozuesi nuk vijen në seancë, ose nuk do të paraqitet në thirrjen e gjyqit dhe pse është thirrur me rregull, ndërsa nuk ekziston rrethanat e njohura të përgjithshme, që e kanë penguar të vijë në gjyq. Shkaqet e arsyeshme për mungesën, gjyqi mund t'i pranojë edhe pa u deklaruar për këtë pjesëmarrësit e tjerë, deri sa nuk u dërgon njoftim për tërheqjen e propozimit. Pjesëmarrësit e tjerë të cilët sipas ligjit janë të autorizuar që ta iniciojnë procedurën, mund të propozojnë që procedurat të vazhdojnë. Propozimi për vazhdimin e procedurës, mund të paraqitet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për tërheqjen e propozimit.

2.3.1 Objekti i procedurës

Sic u sqarua më sipër, mosha madhore është një nga kushtet për lidhjen e një martese të vlefshme. Nuk mund të lidhë martesë personi që nuk ka mbushur 18 vjeç. Gjithashtu dhe gjinia e personave përbën pengesë për lidhjen e martesës. Krahas të afërmeve në gjini gjaku në vijë të drejtë dhe të tërthortë, të përcaktuar me ligj, nuk mund të lidhin martesë me njëri-tjetrin dhe personat në gjini krushqie. Martesë nuk mund të lidhin vjehrrin dhe e reja, vjehrra dhe dhëndërrin,

njerku dhe thjeshtira, njerka dhe thjeshtiri, pavarësisht nëse martesë, në bazë të së cilës është krijuar gjinia e krushqisë ka pushuar.⁵⁴

Megjithatë, në disa raste, mituria dhe gjinia e krushqisë si pengesa martesore mund të hiqen. Kështu, në procedurë të veçantë jashtëkontestimore, gjykata mund t'u japë leje për të lidhur martesë personave, tek të cilët ekzistojnë këto pengesa martesore.

Gjykata kompetente në procedurë jashtëkontestimore mund të lejojë lidhjen e martesës së personit që ka mbushur 16 vjeç, nëse vërtetohet se ka arritur pjekurinë e duhur mendore dhe trupore për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga martesë, dhe në bazë të mendimit paraprak të institucionit shëndetësor dhe ndihmën profesionale të Qendrës për punë sociale.⁵⁵

Gjithashtu, në procedurë jashtëkontestimore, gjykata mundet, për shkaqe të arsyeshme, të lejojë lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie, të përmendur më sipër.⁵⁶

Nga ana tjetër, Ligji për procedurë jashtëkontestimore parashikon se në procedurën për dhënien e lejes për lidhjen e martesës, gjykata vendos për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave të caktuar, kur me ligj është parashikuar kushti se martesë midis këtyre personave mund të lidhet vetëm në bazë të lejes së gjykatës.⁵⁷

2.3.2Kompetenca vendore e gjykatës

Gjykata në RMV është kompetente për dhënien e lejes për lidhjen e martesës nga i mituri kur paraqitësi i kërkesës është shtetas i RMV-së, respektivisht kur njëri nga paraqitësit e kërkesës është shtetas i RMV-së, pavarësisht vendbanimit të personave që duan të lidhin martesë. Nëse i mituri që kërkon leje për lidhjen e martesës është shtetas i RMV-së, respektivisht nëse të dy personat që duan të lidhin martesë janë shtetas të RMV-së, ndërsa martesë lidhet jashtë vendit, ekziston kompetencë ekskluzive e gjykatës së RMV-së.⁵⁸

Për dhënien e lejes për lidhjen e martesës të personit të mitur që ka mbushur 16 vjeç kompetente është gjykata në territorin e së cilës ai person ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Nëse të dy

⁵⁴ Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

⁵⁵ Neni 16, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

⁵⁶ Neni 21, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

⁵⁷ Neni 93 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁵⁸ Neni 83 i Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare Private i RMV-së

personat që duan të lidhin martesë janë të mitur, dhe nuk kanë vendbanim ose vendqëndrim të njëjtë, kompetencën territoriale e ka gjykata kompetente për njërin prej tyre.⁵⁹

Kur bëhet fjalë për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie, gjithashtu, kompetencën territoriale e ka gjykata, në territorin e së cilës kanë vendbanim, respektivisht vendqëndrim këta persona. Nëse personat nuk kanë vendbanim apo vendqëndrim në territorin e të njëjtës gjykate, kompetencën territoriale e ka gjykata që është kompetente për njërin prej tyre.

2.3.3 Inicimi dhe zhvillimi i procedurës

Procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës iniciohet me propozim. Propozimin e paraqet personi i mitur.⁶⁰ Nëse të dy personat që duan të lidhin martesë janë të mitur, ata paraqesin propozim të përbashkët për t'ju lejuar lidhja e martesës tek gjykata që ka kompetencë territoriale për njërin prej tyre.⁶¹ Personat në gjini krushqie që duan të lidhin martesë, gjithashtu dorëzojnë propozim të përbashkët në gjykatën që ka kompetencë territoriale për njërin prej tyre.⁶²

Përmbajtja e propozimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës së personit të mitur, që ka mbushur 16 vjeç është e përcaktuar me ligj.⁶³ Propozimi duhet të përmbajë të dhënat personale për të miturin/it, për prindërit e tij/tyre, respektivisht për kujdestarin, si dhe të dhënat për personit me të cilin do të lidhet martesa. Përveç kësaj, në propozim duhet të përfshihen dhe provat se i mituri e ka arritur pjekurinë e nevojshme mendore dhe trupore për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga martesa.

Ligji për procedurë jashtëkontestimore nuk e përcakton përmbajtjen e propozimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie, as nuk parashikon zbatim për analogji të dispozitave për përmbajtjen e propozimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës së personit të mitur. Duhet pasur parasysh se në propozimin për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie duhet të renditen të dhënat personale të personave që

⁵⁹ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 99

⁶⁰ Neni 95 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁶¹ Neni 96 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁶² Neni 103 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁶³ Neni 97 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

duan të lidhin martesë, si dhe provat për ekzistencën e rrethanave nga të cilat del se ka shkaqe të arsyeshme për lidhjen e martesës midis këtyre personave.⁶⁴

Në procedurën për dhënien e lejes për lidhjen e martesës gjykata duhet t'i vërtetojë të gjitha faktet e rëndësishme, relevante për sjelljen e aktvendimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës.

Kur bëhet fjalë për dhënien e lejes për lidhjen e martesës së të miturve gjykata është e detyruar veçanërisht të vërtetojë nëse i mituri e ka arritur pjekurinë e nevojshme mendore dhe trupore për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet që lindin nga martesë. Gjithashtu gjykata duhet të vërtetojë se personi i mitur në mënyrë të lirë dhe të mirëmenduar ka marrë vendim për lidhjen e martesës, dhe se martesë nuk do të lidhet nën kushte të shtrëngimit, mashtrimit apo lajthimit.

Gjykata ka detyrimin t'i shqyrtojë dhe cilësitë personale, gjendjen pronësore dhe rrethana të tjera thelbësore që kanë të bëjnë me personin me të cilin i mituri do të lidhë martesë.⁶⁵

Me qëllim të përcaktimit të rrethanave të rëndësishme të rastit, gjykata i thërret për t'i dëgjuar, propozuesin, personin me të cilin ai do të lidhë martesë, prindërit apo kujdestarin e propozuesit nëse ai është i mitur. Në procedurën e shkallës së parë për dhënien e lejes për lidhjen e martesës së personit të mitur, prindërit e të miturit nuk kanë statusin e pjesëmarrësit në procedurë. Ata janë vetëm persona me dëshmitë e të cilëve gjykata mund të përcaktojë fakte të rëndësishme për marrjen e vendimit.

Dëgjimi i të miturit kryhet veçmas, pa praninë e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Nëse gjykon se është e nevojshme, gjykata mund të caktojë seancë.

Gjatë zhvillimit të procedurës, gjykata ka detyrimin të sigurojë mendimin e institucionit shëndetësor për pjekurinë trupore dhe mendore të të miturit dhe të sigurojë ndihmë profesionale nga Qendra për punë sociale.

Kur procedura zhvillohet për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie gjykata ka detyrimin t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat dhe të vërtetojë nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për lidhjen e martesës. Ligjvënësi nuk e ka përcaktuar domethënien e shkakut të arsyeshëm për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie. Kjo do të thotë se gjykata në çdo rast konkret duhet ta përcaktojë përmbajtjen e termit “shkak i arsyeshëm” për lidhjen e martesës. Në teori dhe praktikë konsiderohet se gjykata veçanërisht duhet të ketë

⁶⁴ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, “Gragjansko procesno pravo – kniga vtora – Vonparnicno pravo”, Skopje, 2010, fq. 99

⁶⁵ Neni 98 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

parasysh botëkuptimet dhe zakonet që mbizotërojnë tek njerëzit në rrethin ku jetojnë personat në gjini krushqie. Në rrethe të caktuara nuk është e jashtëzakonshme që personat në gjini krushqie të lidhin martesë. Përkundrazi, kjo konsiderohet normale dhe në funksion të mbrojtjes së familjes dhe interesave të saj.⁶⁶

Mund të ekzistojnë situata kur tek paraqitësit e propozimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës ekziston kumulimi i dy pengesave martesore: propozuesit janë në gjini krushqie, por njëkohësisht njëri prej tyre, ose të dy, janë persona të mitur. Në këto raste, gjatë zhvillimit të procedurës gjykata duhet të vërtetojë nëse ekzistojnë të gjitha rrethanat thelbësore të cilat e justifikojnë aktvendimin e gjykatës për heqjen e të dy pengesave martesore.

Në procedurën për dhënien e lejes për lidhjen e martesës publiku është i përjashtuar.

2.3.4 Aktvendimi dhe pasojat juridike të aktvendimit

Pasi ndërmerr të gjitha veprimet e parashikuara me ligj dhe vërteton të gjitha faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit, gjykata nxjerr aktvendim me të cilin e miraton propozimin dhe jep leje për lidhjen e martesës ose nëse nuk janë përmbushur kushtet për këtë, nxjerr aktvendim me të cilin e refuzon dhënien e lejes për lidhjen e martesës.

Leja për lidhjen e martesës që i është dhënë personit të mitur nuk përbën leje të përgjithshme për lidhjen e martesës me cilindo person, por leje për lidhjen e martesës midis personave saktësisht të përcaktuar. Kështu, në dispozitivin e aktvendimit me të cilin të miturit i lejohet lidhja e martesës përcaktohet me cilin person i lejohet të lidhë martesë, si dhe ajo se martesa mund të lidhet pas hyrjes në fuqi të aktvendimit. Në arsyetimin e aktvendimit me të cilin jepet leja për lidhjen e martesës, gjyqi i shënon faktet dhe rrethanat në bazë të të cilave, ka dalë në përfundimin se ekziston pjekuria trupore dhe psikike e të miturit, e nevojshme për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që vijnë nga martesa.⁶⁷

Aktvendimi me të cilin lejohet lidhja e martesës i dorëzohet personit të mitur, prindërve të tij, përkatësisht kujdestarit dhe Qendrës për punë sociale, ndërsa aktvendimi me të cilin refuzohet kërkesa, i dorëzohet vetëm personit të mitur.⁶⁸

⁶⁶ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtora – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 100

⁶⁷ Neni 99 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁶⁸ Neni 100 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

Edhe në dispozitivin e aktvendimit për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie gjykata i përcakton me emër personat të cilëve u lejohet të lidhin martesë dhe cakton se martesë mund të lidhet pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Aktvendimi për dhënien e lejes për lidhjen e martesës ka karakter konstitutiv për arsye se aktvendimi përbën bazë për lidhjen e martesës. Pa këtë aktvendim nuk mund të lidhet martesë e plotfuqishme, për shkak të ekzistencës së pengesave martesore.⁶⁹

Aktvendimi për dhënien e lejes për lidhjen e martesës së personit të mitur nuk sjell pasoja në zotësinë për të vepruar të personit të mitur. I mituri e fiton zotësinë për të vepruar vetëm pasi në bazë të lejes lidh martesë. Pra, sa i takon fitimit të zotësisë së përgjithshme për të vepruar të të miturit, efekt konstitutiv ka lidhja e martesës dhe jo aktvendimi i plotfuqishëm me të cilin jepet leja për lidhjen e martesës.

2.3.5 Mjetet juridike

Kundër aktvendimit me të cilin jepet leje për lidhjen e martesës dhe kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi mund të parashtrohet ankesë.

Personat e autorizuar për të parashtruar ankesë kundër aktvendimit me të cilin lejohet lidhja e martesës janë prindërit ose kujdestari i të miturit, edhe pse gjatë procedurës në shkallë të parë nuk e kanë pasur statusin e pjesëmarrësve, si dhe Qendra për punë sociale. Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për dhënien e lejes për lidhjen e martesës ankesë mund të paraqesë vetëm personi i mitur.⁷⁰

Kur procedura është zhvilluar për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie, kundër aktvendimit me të cilin refuzohet ose lejohet lidhja e martesës ankesë mund të paraqesin vetëm paraqitësit e propozimit.⁷¹

2.3.6 Shpenzimet e procedurës

⁶⁹ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 101

⁷⁰ Neni 101 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

⁷¹ Neni 105 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

Në mungesë të një dispozite të veçantë për kompensimin e shpenzimeve të procedurës për dhëniene e lejes për lidhjen e martesës, zbatohet dispozita e përgjithshme e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, sipas së cilës shpenzimet e procedurës i ngarkohen atij pjesëmarrësi në interes të të cilit është iniciuar procedura.⁷²

KAPITULLI III

PROCEDURA JASHTËKONTESTIMORE PËR MARRJEN E TË DREJTAVE PRINDËRORE, PËRCAKTIMIN QË PRINDËRIT TË KENË POZITËN E KUJDESTARIT DHE KTHIMIN E TË DREJTAVE PRINDËRORE

⁷² Neni 32 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

3.1 Koncepti i përgjegjësisë prindërore

Sipas Ligjit për familjen të RMV-së, e drejta prindërore përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e prindërve që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe të fëmijëve mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore.⁷³

Ndërsa sipas legjislacionit shqiptar, përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.⁷⁴

Marrëdhënia prindërore e krijuar, si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga përmbajtja e saj nuk mund të ndryshohen në bazë të dëshirës së prindërve. Kjo për arsye se marrëdhënia midis prindërve dhe fëmijëve është e rregulluar me norma juridike me karakter imperativ. Kështu që autonomia e vullnetit është e kufizuar dhe shfaqet vetëm kur personi vendos të krijojë marrëdhënie prindërore, me lindje ose adoptim.⁷⁵

Marrëdhënia prindërore është me karakter të përhershëm dhe mund të ndërpritet vetëm me vdekjen e prindit ose të fëmijës. Ndërsa, për dallim nga marrëdhënia prindërore, e drejta prindërore që përfshin të drejtat dhe detyrimet e prindërve përfundon me arritjen e moshës madhore të fëmijëve, me lidhjen e martesës së fëmijës përpara arritjes së moshës madhore, me adoptim dhe me vdekje.

Prindërit kanë, përpara së gjithash, detyrime kundrejt fëmijëve të tyre. Për këtë arsye, në vend të termit “e drejtë prindërore” gjithmonë e më tepër po përdoret termi “përgjegjësi prindërore”.⁷⁶

Në konceptin e përgjegjësisë prindërore të sanksionuar nga legjislacionet bashkëkohore kemi një ndryshim të marrëdhënies prind fëmijë pasi kjo marrëdhënie i largohet konceptit tradicional të pushtetit ose të *patria potestas* të *paterfamiljas* mbi fëmijën. Në këtë mënyrë u jepet më tepër epërsi detyrimeve prindërore që lindin nga kjo marrëdhënie. Ashtu si marrëdhëniet e tjera të zakonshme juridike edhe ajo ndërmjet prindërve e fëmijëve ka të drejta e detyrime të cilat lindin nga fakti juridik i riprodhimit apo i adoptimit të një fëmijë.

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve janë të njëjta, pavarësisht burimit të lindjes së marrëdhënies prindërore, e cila mund të jetë lidhje biologjike apo deklarim vullneti, si edhe s’ka rëndësi

⁷³ Neni 44 i Ligjit për Familjen

⁷⁴ Neni 215 i Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë

⁷⁵ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 172-173

⁷⁶ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 197-198

statusiligjor i fëmijës nëse është i lindur nga martesë apo jashtë saj për funksionimin e kësaj marrëdhënieje. Përgjegjësia prindërore është përmbledhja e detyrave dhe përgjegjësive të cilat si synim primar kanë sigurimin e mirëqenies morale dhe materiale të fëmijës. Përgjegjësia prindërore realizohet fillimisht duke u kujdesur vetë prindi për fëmijën. Kjo lloj përgjegjësie ushtrohet nga vetë prindërit dhe ata nuk mund ta cedojnë, trashëgojnë, besojnë apo t'a mbartin si mënyrëshlyerjeje të detyrimeve të persona të tjerë.

Kjo përgjegjësi hyn në grupin e të drejtave subjektive dhe është e lidhur ngushtë me personalitetin e prindërve. Prindërit duhet ta trajtojnë fëmijën si një individualitet më vetë i cili meriton vëmendje, kujdes e përkushtim gjatë rritjes, tëmbahen marrëdhënie të drejtpërdrejta e vetjake me të për mirërritjen, edukimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij nëse mund të disponojë të tilla. Në përmbajtje të përgjegjësisë prindërore bëjnë pjesë të gjitha të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit në raport me fëmijën e tyre dhe që burojnë nga të qenit nënë ose baba i fëmijës.

Marrëdhëniet që krijohen midis këtyre dy subjekteve të kësaj marrëdhënie kaq të veçantë janë me karakter jo pasuror ose vetjak dhe me karakter pasuror. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbështetjes morale dhe materiale nga ana e prindërve deri sa të arrijnë moshën madhore. Prindërimi është proces i shumëanshëm dhe i vështirë, rezultati i të cilit është formimi i një personaliteti moralisht korrekt, i aftë të përshtatet në shoqëri dhe të kontribuojë për veten dhe shoqërinë, si dhe të jetojë një jetë të plotë e të lumtur. Edukimi i fëmijëve përfshin shumë aspekte - ky është edukimi i një fëmije si një personalitet i pasur shpirtërisht, edukimi i një personi në kuptimin moral dhe etik, edukimi fizik, seksual, edukimi i disa tipareve të karakterit, etj. Prindërimi është përgjegjësi e prindërve, që dallohet nga çdo punë apo detyrë tjetër e tyre.

Detyrë e prindërve është të rrënjësojnë tek fëmija vlerat, bazat dhe pikëpamjet e duhura morale bazuar në parimin “mos i bëj dëm tjetrit”. Shembulli personal i prindërve është metoda e vetme e vërtetë dhe më e fuqishme edukative.

Por përveç përgjegjësisë për edukimin moral, ka përgjegjësi prindërore për aspekte të tjera të edukimit të përmendura më sipër. Janë prindërit ata që u japin fëmijëve idetë e para se çfarë është e drejtë dhe e gabuar, çfarë të bëjnë dhe çfarë të mos bëjnë, si ta shikojnë botën dhe si ta vlerësojnë atë, etj.

Përveç përgjegjësisë morale në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale, prindërit janë përgjegjës edhe para ligjit për mënyrën se si i rrisin fëmijët e tyre, qofshin ata biologjikë ose të adoptuar. Ligji e

thotë këtë drejtpërdrejt: një prind është i detyruar t'u sigurojë fëmijëve të tij të birësuar të gjitha llojet e mbështetjes dhe ndihmës, për t'u kujdesur për ta, për të kënaqur nevojat e tyre fizike dhe materiale. Gjithashtu, prindërit duhet t'i mbrojnë fëmijën e tyre, të drejtat e tyre, t'u sigurojnë atyre gjithçka që është e nevojshme për një jetë të plotë e të shëndetshme. Kushtetuta dhe Ligji për familjen, rregullojnë aspekte të mirërritjes së fëmijëve, flasin për detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve ndaj shoqërisë dhe vetë fëmijëve. Prindërit kanë detyrimin të kujdesen, ushqejnë, edukojnë dhe zhvillojnë fëmijët e tyre deri në moshën 18 vjeç. Prindërit janë përgjegjës për shëndetin e tyre mendor dhe fizik.

Familja është njësia bazë e shoqërisë si dhe bashkësi kryesore e prindërve dhe fëmijëve . Por, në jetën e përditshme ndodh që prindërit të kenë konflikte gjë që sjell si pasojë ka zgjidhjen e martesës. Në këto raste fëmijët janë viktimë, sidomos kur janë në pyetje të drejtat e tyre. Fëmijët kanë nevojë për mbrojtje të veçantë. Praktika ka treguar se fëmijëve u cenohen të drejtat e tyre. Edhe përkundër detyrimit ligjor të prindit që të kujdeset për ushqimin e fëmijëve, ata i ikin këtij detyrimi, duke u arsyetuar me atë se nuk kanë mundësi për ta paguar ushqimin, se janë të pa punësuar apo se shuma e kërkuar, është e lartë.

Problem i veçantë, është mos krijimi i kushteve për realizimin e kontaktit të fëmijës me prindin, i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore mbi të. Si çështje me rëndësi është edhe mos dhënia e prokurës nga prindi, i cili nuk e ka në përkujdesje fëmijën për nxjerrjen e dokumentit të udhëtimit të fëmijës.

Prindërit dhe organet shtetërore në çështjet familjare janë të detyruara të mbrojnë interesin më të lartë të fëmijëve kur ata janë të mitur. Në rend të parë këtë detyrë e kanë prindërit, por nëse ndërmjet tyre ka kontradikta thelbësore, ndërhyrja e një organi kompetent nuk bëhet për të zëvendësuar prindërit, por për të mbajtur nën kontroll realizimin e interesit më të mirë të fëmijës në kushtet e krijuara.⁷⁷ Edhe fëmijët e lindur në bashkësi jashtëmartesore (bashkëjetesë) gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët e lindur në martesë. Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore edhe te këta fëmijë mund të bëhet me marrëveshje, por në rast mosmarrëveshjeje mes partnerëve bashkëjetues, vlerësimi i mënyrës së ushtrimit të saj do të bëhet nga gjykata duke marrë për bazë parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.⁷⁸ Në praktikë, ndodhin edhe dështime në rastet e

⁷⁷ Zejnullah Gruda, Të Drejtat e Fëmijës, Monografi për të Drejtat e Njeriut, nr. 9 Prishtinë, 2005, fq. 17

⁷⁸ Arta Mandro, E Drejta Familjare, Tiranë, 2009, fq.51

sigurimit të të drejtave të fëmijëve me rastin e divorcit të prindërve siç janë: e drejta e ushqimisë, kontaktit dhe lëvizjes së lirë.⁷⁹

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve kanë të bëjnë me formimin e personalitetit të tyre, përkujdesjen, rritjen, edukimin, aftësimin profesional, si dhe mbrojtjen e interesave të tyre pasurorë. Nisur nga kjo, në teorinë juridike, të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve janë të ndara në dy grupe: 1) të drejta dhe detyrime ndaj personalitetit të fëmijës dhe 2) të drejta dhe detyrime ndaj pronës së fëmijës.⁸⁰

3.1.1 Të drejtat dhe detyrimet personale jopasurore të prindërve ndaj fëmijëve

Të drejta personale, jopasurore të prindërve ndaj fëmijëve janë të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj personalitetit të fëmijës, ku bëjnë pjesë:⁸¹

- 1) caktimi i emrit personal të fëmijës,
- 2) ruajtja dhe përkujdesi ndaj fëmijës,
- 3) edukimi i fëmijës,
- 4) shkollimi dhe aftësimi profesional i fëmijës,
- 5) mbajtja dhe ushqimi i fëmijës dhe
- 6) përfaqësimi i fëmijës.

*Prindërit kanë të drejtën dhe detyrimin të caktojnë emrin personal të fëmijës. Këtë ata e caktojnë bashkërisht dhe me marrëveshje.*⁸² Nëse prindërit nuk mund të merren vesh për caktimin e emrit ose kur prindërit janë të panjohur, emrin e cakton organi kompetent për kujdestarinë, që është Qendra për punë sociale, apo kujdestari i fëmijës me pëlqimin e organit të kujdestarisë. Ndërsa mbiemri i fëmijës caktohet sipas mbiemrit të njërit ose të dy prindërve, përveç kur prindërit vendosin që fëmija të ketë mbiemër tjetër. Nëse prindi nuk është gjallë, nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën prindërore ose është i panjohur, emrin e fëmijës e cakton prindi tjetër. Por, kur të dy prindërit nuk janë gjallë ose nuk kanë mundësi të ushtrojnë të drejtën prindërore, emrin personal të fëmijës e vendos organi i kujdestarisë ose kujdestari me pëlqimin e organit të

⁷⁹ Lamçe J & Lamçe Y., Kuptimi I Institutit të Bashkëjetesës në Legjislacionin Shqiptar, Parimi i Heteroseksualitetit si Kufizim që bie ndesh me Legjislacionin dhe Jurisprudencën Europiane, Konferenca shkencore kombëtare, "Shteti dhe drejtësia shqiptare në 100 vjet pavarësi", UET, 2012, fq.6

⁸⁰ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 190

⁸¹ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 215

⁸² Neni 3, paragrafi 1 i Ligjit për Emrin Personal

kujdestarisë sipas mbiemrit të njërit ose të të dy prindërve. Emrin personal të fëmijës së adoptuar e caktojnë adoptuesit. Nëse fëmija i adoptuar ka emër personal, adoptuesit mundën gjatë adoptimit t'i caktojnë mbiemrin e tyre ose mbiemër tjetër, përveç rastit kur në aktin e adoptimit është përcaktuar që i adoptuari të mbajë mbiemrin e tij ose mbiemrit të tij t'i shtohet mbiemri i adoptuesve. Emri dhe mbiemri i caktuar mund të ndryshohet. Personit të mitur mund t'i ndryshohet emri personal, respektivisht vetëm emri ose mbiemri me kërkesë të prindërve ose adoptuesve, apo me kërkesë të kujdestarit me pëlqimin e organit të kujdestarisë. Por, nëse kërkohet ndryshimi i emrit personal të fëmijës që ka mbushur moshën 10 vjeç, nevojitet dhe pëlqimi i tij.⁸³

Prindërit kanë detyrimin t'i ruajnë dhe të përkujdesen për fëmijët dhe për shëndetin e tyre. Ata janë të detyruar të sigurojnë kushtet për përkujdesje dhe zhvillim të fëmijës, si dhe për mbrojtjen e shëndetit të tyre. Në raste të problemeve shëndetësore të fëmijës, ata janë të detyruar të sigurojnë ndihmë mjekësore si dhe t'i marrin të gjitha masat për mjekim të fëmijës. Në këtë drejtim, një rol të madh luan dhe shteti nëpërmjet aktivitetit të institucioneve shëndetësore, institucioneve parashkollore dhe benefiteve të parashikuara për nënat. Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijëve i njihet e drejta e jetës dhe gëzimit të standardeve më të larta shëndetësore. Këtë të drejtë fëmija nuk mund ta realizojë pa ndihmën e prindërve të tij, ndërsa realizimi i kësaj të drejte është parakusht për realizimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të tjera.⁸⁴

Prindërit kanë detyrimin të caktojnë vendbanimin e fëmijës. Banesa familjare ka një rëndësi të madhe për familjen dhe për ruajtjen, rritjen dhe zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Në pjesën më të madhe të rasteve fëmijët jetojnë së bashku me prindërit e tyre.⁸⁵ Kjo është një nga të drejtat kryesore të fëmijës, e garantuar me Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës. Kur fëmija jeton me të dy prindërit e tij, mundësitë për përmbushjen e të gjitha nevojave të tij janë më të mëdha, prindërit më me sukses kujdesen për jetën dhe shëndetin e tij dhe sigurohet një zhvillim

⁸³ Albana Metaj-Stojanova "Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile" në "Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja", Tetovë, 2022, fq. 181-183

⁸⁴ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 191

⁸⁵ Metaj-Stojanova, Albana. A Comparative View on the Legal Protection of Family Home and the Current Situation in RM. In *Proceedings of the 11-th Annual South-East European Doctoral Student Conference: Infusing Research and Knowledge in South-East Europe*, pp. 109-119. South-East European Research Centre, Thessaloniki, Greece, 5 / 2017, marrënga: <https://www.seerc.org/yw/2017/files/DSC2017-Proceedings.pdf>

psikik më stabil i personalitetit të fëmijës. Ligji për familjen përcakton se fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre.⁸⁶ Ata mund të jetojnë veçmas nga prindërit vetëm kur kjo është në interes të drejtpërdrejtë të tyre ose kur kjo është në interes të përbashkët të prindërve dhe fëmijëve. Nëse fëmija i është besuar për rritje dhe edukim vetëm njërit prind, prindi me të cilin fëmija nuk jeton ka të drejtën dhe detyrimin të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën e tij.⁸⁷ Ligji parashikon se dhe fëmija ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindin me të cilin nuk jeton. Kjo i referohet rastit kur martesë është shkurorëzuar, ndërsa fëmijët i janë besuar për rritje dhe edukim prindit tjetër, si dhe kur për shkaqe të tjera njëri prind e ka të pamundur të ushtrojë të drejtën e vet prindërore. Ligjvënësi parashikon që prindërit me marrëveshje ta rregullojnë mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale me fëmijën. Në rast të kundërt, nëse nuk arrihet një marrëveshje e tillë, ose kur për çfarëdo lloj arsyeje nuk mund të realizohet kjo e drejtë e fëmijës së mitur, Qendra për punë sociale merr vendim me të cilin përcakton mënyrën e mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijës me prindin. Përveç prindërve, fëmijët e mitur kanë të drejtë të mbajnë kontakte të drejtpërdrejta me prindërit dhe të afërmit e tjerë të prindit që ka vdekur, që i është hequr e drejta prindërore ose që për arsye të tjera nuk ka mundësi ta ushtrojë të drejtën prindërore.⁸⁸

Prindërit kanë të drejtën dhe detyrimin t'i edukojnë fëmijët e tyre. Roli i prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të fëmijëve. Edukimi i drejtë i fëmijëve ndikon pozitivisht në zhvillimin e tyre, nëse prindërit i drejtojnë drejt vlerave të vërteta shoqërore. Edukimi nga ana e prindërve është një hallkë kyçe në procesin e ndërtimit të personalitetit të fëmijës dhe krijimin e zakoneve të tij. Në të kundërt, nëse prindërit e lënë pas dore edukimin e drejtë të fëmijës, apo e drejtojnë drejt sjelljeve të caktuara negative dhe devijante, ata mbajnë përgjegjësi për dëmin që do të shkaktojë fëmija. Nga përgjegjësia për kompensimin e dëmit, prindërit do të lirohen, vetëm nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre.⁸⁹

Prindërit kanë detyrimin të kujdesen për shkollimin, edukimin dhe aftësimin profesional të fëmijëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e arsimimit dhe përfitimet që sjell për personalitetin e fëmijës, prindërit janë të detyruar të kujdesen që fëmija të marrë arsim të përshtatshëm me qëllim

⁸⁶ Neni 47, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

⁸⁷ Neni 47, paragrafi 4 i Ligjit për Familjen

⁸⁸ Neni 47, paragrafi 5 i Ligjit për Familjen

⁸⁹ Albana Metaj-Stojanova "Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile" në "Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja", Tetovë, 2022, fq. 179-180

që të përgatitet për jetë të pavarur. Legjislacioni ynë parashikon arsim të detyrueshëm falas për fëmijët deri në përfundimin e arsimit të mesëm. Megjithatë, edhe pas përfundimit të arsimit të mesëm, shteti parashikon një sërë lehtësirash në interes të fëmijëve që do të vazhdojnë arsimin profesional ose arsimin e lartë.⁹⁰

Prindërit kanë detyrimin t'i mbajnë dhe ushqejnë fëmijët e tyre të mitur. Prindërit janë të detyruar të krijojnë kushte materiale për jetën e fëmijëve të mitur, nëpërmjet sigurimit të banesës, ushqimit, veshjeve dhe gjithë nevojave të tjera. Ligjvënësi nuk e përcakton konkretisht përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së fëmijëve, duke ua lënë prindërve, sipas mundësive të tyre, të kujdesen për sigurimin e mjeteve për mbajtjen e fëmijëve. Kur prindërit janë në martesë dhe jetojnë së bashku, ata janë të detyruar bashkërisht t'i mbajnë dhe ushqejnë fëmijët e tyre. Por, detyrimi për mbajtjen dhe ushqimin e fëmijëve u ngarkohet të dy prindërve edhe pas zgjidhjes së martesës. Prindërit kanë detyrimin t'i mbajnë dhe ushqejnë fëmijët e tyre deri në arritjen e moshës madhore. Por, ekzitojnë dy përjashtime nga ky rregull. *Së pari*, nëse shkollimi dhe arsimi profesional i fëmijëve vazhdon dhe pas moshës madhore, prindërit janë të detyruar të vazhdojnë t'i mbajnë dhe ushqejnë fëmijët deri në përfundimin e rregullt të shkollimit, por më së voni me mbushjen e moshës 26 vjeç. *Së dyti*, nëse personi i moshës madhore është i paaftë për punë për shkak të sëmundjes, paaftësisë fizike ose mendore, nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë dhe as nuk mund t'i fitojë nga prona e vet, prindërit janë të detyruar ta mbajnë dhe ushqejnë për sa kohë zgjat paaftësia.⁹¹

Prindërit gjithashtu kanë të drejtën dhe detyrimin t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur. Në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve në qarkullimin juridik fëmijët e mitur përfaqësohen nga të dy prindërit. Kjo e drejtë dhe detyrim u takon të dy prindërve njësoj, nëse ata jetojnë së bashku. Nëse jetojnë veçmas, atëherë fëmija përfaqësohet nga prindi të cilit fëmija i është besuar për rritje dhe edukim. Në këto raste prindërit shfaqen si përfaqësues ligjorë të fëmijëve të tyre. Dispozitat që kanë të bëjnë me shprehjen e vullnetit juridikisht relevant të të miturve janë të përfshira në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve të RMV-së. Me pronën e fëmijës së mitur administrojnë dhe disponojnë prindërit e tij. Por, të ardhurat nga prona e fëmijës, prindërit fillimisht mund t'i përdorin për mbajtjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës, si dhe për nevojat e domosdoshme të bashkësisë familjare, nëse ata vetë nuk kanë mjete të mjaftueshme për

⁹⁰ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 217

⁹¹ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 192-193

mbulimin e këtyre shpenzimeve.⁹² Por, nuk ndodh kështu me pronën të cilën i mituri e fiton me punën e tij. E drejta dhe detyrimi i prindërve për t'i përfaqësuar fëmijët e tyre të mitur nuk ka karakter absolut dhe në raste të caktuara me ligj mund të kufizohet. Qendra për punë sociale luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.⁹³ Prindërit nuk mund t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur në raste të caktuara, p.sh. në punë dhe veprime juridike që janë të lidhura ngushtë me personalitetin e fëmijës, siç është p.sh. dhënia e lejes për lidhjen e martesës, lidhja e martesës, si dhe në rastet kur prindërit dhe fëmijët e mitur kanë interesa të kundërta. Legjislacioni ynë parashikon shumë situata kur fëmija i mitur ka të drejtë të shprehë vullnetin e tij në mënyrë të pavarur, megjithëse është i mitur. P.sh. nëse fëmija është mbi 16 vjeç nevojitet dhe pëlqimi i tij për njohjen e atësisë. I mituri mbi 15 vjeç, që ka zotësi të pjesshme për të vepruar mund të krijojë marrëdhënie pune, mund të disponojë lirisht me të ardhurat e veta të fituara nga marrëdhënia e punës, t'i deponojë në bankë, etj.⁹⁴ Sipas Ligjit për familje, i mituri nën kujdestari që ka mbushur moshën 15 vjeç, mundet vetë, pa miratimin e kujdestarit, të krijojë marrëdhënie pune dhe lirisht të disponojë me pagën e fituar, por është i detyruar që të kontribuojë për mbajtjen dhe ushqimin e tij, edukimin dhe aftësimin profesional.⁹⁵

3.1.2 Të drejtat dhe detyrimet ndaj pasurisë së fëmijës

Prindërit kanë të drejta dhe detyrime edhe kundrejt pasurisë së fëmijëve të tyre të mitur që shfaqen në aspekt të:⁹⁶

- 1) administrimit me pasurinë e fëmijës,
- 2) përdorimit të të ardhurave nga pasuria e fëmijës dhe
- 3) tjetërsimi apo ngarkimi me barrë i pronës së fëmijës.

Me fitimin e zotësisë juridike, fëmija i mitur mund të fitojë pasuri të vetën. Më së shpeshti bëhet fjalë për pasuri të fituar nëpërmjet trashëgimisë apo dhurimit. Këtë pasuri, deri në arritjen e moshës madhore të fëmijës e administrojnë prindërit e tij, nëse jetojnë së bashku. Në rastin kur

⁹² Neni 221 i Ligjit për Familjen

⁹³ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 219

⁹⁴ Abdulla Aliu, E drejta civile, Prishtinë, 2013, fq. 242-243

⁹⁵ Neni 162 i Ligjit për Familjen

⁹⁶ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 195

prindërit jetojnë veçmas, me pasurinë e fëmijës së mitur disponon njëri prind, ai të cilit fëmija i është besuar për rritje dhe edukim, nëse Qendra për punë sociale me propozim të prindit tjetër nuk ka vendosur ndryshe.

Prindërit kanë të drejtë t'i përdorin të ardhurat nga pasuria e fëmijës. Të ardhurat nga pasuria e fëmijës prindërit mund t'i përdorin fillimisht për ushqimin, edukimin dhe shkollimin, si dhe për nevojat e domosdoshme të bashkësisë familjare, nëse ata vetë nuk kanë mjete të nevojshme. Nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme për keqpërdorime të pasurisë së fëmijës nga ana e prindërve, Qendra për punë sociale mund të kërkojë nga prindërit që të njoftohet për mënyrën e administrimit të pasurisë së fëmijës. Ajo mund të kërkojë që gjykata, për shkak të mbrojtjes së interesave pasurore të fëmijës, të lejojë marrjen e masave për sigurimin e pronës së prindërve. Qendra mundet gjithashtu, për shkak të mbrojtjes së interesave pasurore të fëmijës, të vendosë, që prindërit në aspekt të administrimit të pasurisë së fëmijës, të kenë rolin e kujdestarit.⁹⁷

Prindërit nuk kanë të drejtë në mënyrë të pavarur ta tjetërsojnë apo ta ngarkojnë me barrë pronën e fëmijës. Por, nëse kjo është e nevojshme për shkak të ushqimit, edukimit dhe arsimimit të fëmijës, ose nëse këtë e diktojnë interesa të tjerë të fëmijës apo nevojat e bashkësisë familjare, prindërit mundën me miratimin e Qendrës për punë sociale ta tjetërsojnë apo ngarkojnë pronën e fëmijës.⁹⁸

3.1.3 Kohëzgjatja e përgjegjësisë prindërore

Prindërit kanë të drejtën dhe detyrimin të kujdesen për fëmijët e tyre të mitur, pra deri sa fëmija të arrijë moshën madhore, 18 vjeç. Por mund të ndodhë që përgjegjësia prindërore të vazhdojë edhe pas arritjes së moshës madhore. Kështu p.sh., nëse shkollimi dhe arsimimi profesional i fëmijëve vazhdon edhe pas moshës madhore, prindërit janë të detyruar të vazhdojnë t'i ushqejnë fëmijët e tyre deri në përfundimin e rregullt të shkollimit e më së voni deri në moshën 26 vjeç.⁹⁹

⁹⁷ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 220

⁹⁸ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 196

⁹⁹ Neni 211, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen.

Po ashtu, nëse personi madhor është i paaftë për punë, për shkak të sëmundjes, të metës fizike ose psikike dhe nuk mjete të mjaftueshme për jetesë e as nuk mund t'i fitojë nga pasuria e tij, prindërit janë të detyruar ta ushqejnë deri sa zgjat paaftësia.¹⁰⁰

Përgjegjësia prindërore mund të përfundojë dhe përpara arritjes së moshës madhore, në rastin kur fëmija i mitur i moshës mbi 16 vjeç lidh martesë. Në bazë të institutit të emancipimit ky fëmijë në çastin e lidhjes së martesës del nga tutela prindërore dhe fiton zotësinë e plotë për të vepruar, që do të thotë se mund të lidhë vetë punë juridike të vlefshme, pa pasur nevojë të përfaqësohet nga prindi ose kujdestari.

3.1.4 Ushtrimi i të drejtës prindërore

Ushtrimi i të drejtës prindërore mbi fëmijët e mitur u takon të dy prindërve njësoj, respektivisht babait dhe nënës dhe realizohet kryesisht në interes të fëmijëve. Ligji për familjen parashikon se të drejtën prindërore prindërit e ushtrojnë së bashku dhe me marrëveshje.¹⁰¹ Sipas parimit të barazisë nëna dhe babai janë të barabartë në të drejtat dhe detyrimet që kanë ndaj fëmijës, të cilat i realizojnë së bashku. Kjo dispozitë është në përputhje me parimin e përgjegjësisë së përbashkët të prindërve, të parashikuar në nenin 18 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Barazia e prindërve është gjithashtu e garantuar nga Protokollin nr. 7 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, me të cilin parashikohet se partnerët martesorë kanë të drejta dhe detyrime të njëjta në marrëdhëniet me fëmijët, si gjatë kohëzgjatjes së martesës, ashtu dhe në rast të pushimit të saj.

E drejta prindërore mund të ushtrohet dhe vetëm nga njëri prind. Kjo ndodh në rastin kur prindi tjetër¹⁰²:

- 1) ka vdekur,

¹⁰⁰ Neni 211, paragrafi 3 i Ligjit për Familjen

¹⁰¹ Neni 76, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

¹⁰² Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, 2015, fq. 222-223

- 2) është shpallur i vdekur,
- 3) është i penguar në ushtrimin e të drejtës prindërore,
- 4) nuk dihet vendbanimi ose vendqëndrimi i tij,
- 5) i është hequr e drejta prindërore,
- 6) i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

Katër arsyet e para janë të një natyre faktike, ndërsa dy arsyet e fundit kanë natyrë juridike. Pasoja e shkaktuar nga vdekja ose vdekja e supozuar sjell në mënyrë të drejtpërdrejtë situatën në të cilën e drejta prindërore ushtrohet nga vetëm njëri prind. Arsyet më të shpeshta që pengojnë ushtrimin e të drejtës prindërore janë puna jashtë shtetit, mungesa më e gjatë për shkak të kurimit dhe trajtimit mjekësor, sëmundja e rëndë dhe ngjitëse, vuajtja e dënimit me burg, etj.

Pamundësia për ushtrimin e përbashkët të së drejtës prindërore nga ana e të prindërve lind edhe në rastin kur dihet vendbanimi ose vendqëndrimi i prindit tjetër. Ndryshe nga pengesa faktike, pengesa juridike e prindit ndodh në rastet kur prindit i është hequr e drejta prindërore apo i është hequr ose kufizuar e drejta për të vepruar. Në këto raste kujdesin për fëmijën e merr përsipër prindi tjetër, ndërsa tjetrin i ngelet detyrimi për mbajtjen dhe ushqimin e fëmijës. Me ndërprerjen e këtyre arsyeve prindi përsëri fiton të drejtën e ushtrimit të së drejtës prindërore në raport me fëmijën.¹⁰³

Kur gjykata e zgjidh martesën, ajo duhet të sjellë vendim se cilit nga prindërit i besohen fëmijët për rritje dhe edukim. Në sjelljen e vendimit, gjykata udhëhiqet nga interesi më i mirë i fëmijës dhe i merr parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit konkret. Vetëm një fakt ose rrethanë nuk është gjithmonë e rëndësishme dhe vendimtare në sjelljen e vendimit nga ana e gjykatës. Sipas qëndrimit të Gjykatës Supreme të RMV-së gjendja e mirë materiale e njërit prind është vetëm një nga treguesit, por nuk është tregues i mjaftueshëm për caktimin e fëmijës tek ky prind për rritje, edukim dhe mbajtje.¹⁰⁴

Duke pasur parasysh se për zhvillimin normal psikik të fëmijës dhe për ndërtimin e personalitetit të tij janë të nevojshëm nëna dhe babai, në legjislacionet bashkëkohore familjare në vend të konceptit të ushtrimit të të drejtës prindërore nga njëri prind po zbatohet koncepti i ushtrimit të

¹⁰³ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, *Semejno pravo*, Skopje, 2013, fq. 199

¹⁰⁴ Dejan Mickovik, Angel Ristov, *Semejno pravo*, 2015, fq. 223

përbashkët të së drejtës prindërore edhe mbas pushimit të martesës. Edhe pse fëmija i besohet për përkujdesje vetëm njërit prind, ushtrimi i përbashkët i të drejtës prindërore nënkupton vendime të përbashkëta për të gjitha çështjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me jetën, shëndetin, arsimimin, shkollimin dhe përfaqësimin e fëmijës. Parakusht themelor për ushtrimin e përbashkët të së drejtës prindërore nga ana e të dy prindërve dhe pas pushimit të martesës është gatishmëria e tyre që së bashku të marrin vendime që janë në interesin më të mirë të fëmijës. Në rast të kundërt, vendimet me rëndësi jetësore për fëmijën i merr vetëm njëri prind, ndërsa tjetri ka vetëm detyrimin të sigurojë mbajtjen dhe ushqimin (alimentacionin) e fëmijës dhe të realizoj kontaktet personale me fëmijën.¹⁰⁵

Të drejtën prindërore prindërit e ushtrojnë së bashku dhe me marrëveshje. Në raste të mosmarrëveshjeve të prindërve në ushtrimin e së drejtës prindërore ndërhyt organi kompetent shtetëror. Sipas legjislacionit tonë familjar, në rast të mosmarrëveshjeve të prindërve në ushtrimin e të drejtës prindërore vendos Qendra për punë sociale.¹⁰⁶

E drejta e fëmijëve për të jetuar me prindërit e tyre ka rëndësi të madhe, prandaj Konventa për të Drejtat e Fëmijës e ndalon ndarjen e fëmijës nga prindërit kundër dëshirës së tyre. Ndarja e fëmijëve nga prindërit lejohet vetëm në raste të veçanta, atëherë kur kjo është e nevojshme dhe në interesin më të mirë të fëmijës, me vendim të organit kompetent shtetëror në procedurë të rregulluar me ligj. Ligji për familjen parashikon se nëse këtë e kërkojnë interesat e fëmijës, prindërit mund t'ia besojnë fëmijën për rritje dhe edukim një personi të tretë ose ta vendosin në institucion përkatës.¹⁰⁷ Nëse prindërit ose prindi që e ushtron i vetëm të drejtën prindërore për shkaqe të arsyeshme një kohë të gjatë mungojnë nga vendi i banimit dhe nuk i marrin fëmijët me vete, fëmijët mund t'ia besojnë për ruajtje dhe edukim një personi tjetër, me kushtin që Qendra për punë sociale ta aprovojë këtë paraprakisht. Do të konsiderohet se aprovimi është dhënë nëse në afat prej 30 ditësh nga dorëzimi i kërkesës Qendra për punë sociale nuk merr vendim. Megjithatë, ligjvënësi shprehimisht parashikon se fëmija nuk mund t'i besohet për rritje dhe edukim një personi që nuk mund të jetë kujdestar.¹⁰⁸

¹⁰⁵ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 199-200

¹⁰⁶ Neni 76, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

¹⁰⁷ Neni 77, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

¹⁰⁸ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, fq. 224

Në rastet kur prindërit e fëmijës nuk jetojnë së bashku, ata merren vesh tek cili prej tyre fëmija do të vendoset për pëkujdesje dhe edukim. Por, nëse ata nuk mund të merren vesh, ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijës, vendim për këtë do të marrë Qendra për punë sociale.¹⁰⁹ Në rast të ndryshimit të rrethanave, edhe vendimi mund të ndryshojë. Kështu, Qendra për punë sociale me kërkesë të njërit prind ose sipas detyrës zyrtare, merr vendim të ri për ta besuar fëmijën për rritje dhe edukim nëse këtë e diktojnë rrethanat e ndryshuara.¹¹⁰

Një nga çështjet më të rëndësishme që shtrihet në rastet kur prindërit nuk jetojnë së bashku është e drejta për mbajtjen e kontakteve personale dhe të drejtpërdrejta me fëmijën.¹¹¹ Ligjvënësi jep mundësinë që prindërit këtë çështje ta zgjidhin me marrëveshje sipas vullnetit të tyre. Por, nëse prindërit e fëmijës në një afat maksimal prej dy muajsh nuk dakordohen për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale dhe të drejtpërdrejta me fëmijën, Qendra për punë sociale merr vendim për këtë. Kjo situatë është shumë e shpeshtë për shkak të marrëdhënieve të prishura të prindërve pas zgjidhjes së martesës, gjë që ndikon negativisht në zhvillimin e fëmijëve. Në legjislacionin tonë nuk ekzistojnë dispozita ligjore që e rregullojnë në mënyrët të detajuara çështjen e llojit dhe vëllimit të kontakteve personale mes njërit prind dhe fëmijës, në rastet kur prindërit nuk jetojnë së bashku. Vendimi për kontaktet është e drejtë diskrecionale e Qendrës për punë sociale, që në praktikë shkakton konflikte të shpeshta, gjë që reflektohet negativisht tek fëmijët.¹¹²

Në marrjen e vendimit për përcaktimin e kontakteve personale dhe të drejtpërdrejta të fëmijës me prindin, Qendra për punë sociale e informon fëmijën dhe është e detyruar t'i marrë parasysh qëndrimet dhe mendimet e tij, në varësi të moshës dhe shkallës së zhvillimit të fëmijës. Njëkohësisht, Qendra për punë sociale e njofton fëmijën për pasojat e mundshme të vendimeve. Një vendim i tillë mund të ndryshohet me kërkesë të prindit dhe Qendra mundet përsëri ta rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale dhe të drejtpërdrejta të prindërve me fëmijët, nëse këtë e diktojnë rrethanat e ndryshuara. Sipas Ligjit për familjen mbajtja e kontakteve personale dhe të drejtpërdrejta të fëmijëve me prindërit mund të kufizohet ose përkohësisht të ndalohet vetëm për shkak të mbrojtjes së shëndetit dhe interesave të tjerë të fëmijës. Në rastin kur nuk realizohet e drejta e fëmijës së mitur për të mbajtur kontakte të

¹⁰⁹ Neni 78, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

¹¹⁰ Neni 78, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

¹¹¹ Neni 79 i Ligjit për Familjen

¹¹² Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 201

drejtpërdrejta me prindërit dhe me familjarë të afërt të prindit që ka vdekur, të prindit që i është hequr e drejta prindërore ose që për shkaqe të tjera nuk mund ta ushtrojë të drejtën prindërore, Qendra për punë sociale merr vendim për mënyrën e mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta.¹¹³

Në rastin e shkurorëzimit të martesës, Ligji për familjen parashikon se me aktgjykimin me të cilin shkurorëzohet martesë, gjykata do të vendosë dhe për ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të përbashkët.¹¹⁴ Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për këtë ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijës, gjykata, pasi të sigurojë mendimin e Qendrës për punë sociale dhe t'i shqyrtojë të gjitha rrethanat, do të vendosë nëse fëmijët do të qëndrojnë për ruajtje dhe edukim tek njëri prind, ose disa do të qëndrojnë me nënën, e të tjerët me babain, apo të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë ose institucioni. Megjithatë, faji për shkurorëzimin e martesës nuk ndikon në vendimin se cilit prind do t'i besohet fëmija për rritje dhe edukim pas shkurorëzimit. Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Supreme e RMV-së, që ka vendosur se “faji për prishjen e marrëdhënieve martesore nga ana e njërit bashkëshort nuk mund të jetë pengesë që atij bashkëshorti t'i besohet fëmija për rritje dhe edukim, nëse këtë e diktojnë interesat e fëmijës.”¹¹⁵

Ligji parashikon shprehimisht se prindi të cilit nuk i besohen fëmijët ka të drejtë të mabjë marrëdhënie personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me ta, nëse gjykata nuk përcakton diçka tjetër duke pasur parasysh interesat e fëmijëve. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme e RMV-së, në një vendim të saj, ka përcaktuar se organi i kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit për mbajtjen e kontakteve personale të prindërve me fëmijën në një martesë të shkurorëzuar, mund të vendosë që prindi të cilit i është caktuar fëmija, t'i mundësojë prindit tjetër përveç kontakteve të rregullta javore, nga një ditë në javë, edhe ta marrë për fundjavë çdo muaj për dy-tre ditë, ndërsa gjatë pushimit vjetor, ta mbajë fëmijën edhe 2-3 javë. Nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara, me kërkesë të njërit nga ish-bashkëshortët e shkurorëzuar ose me kërkesë të Qendrës për punë sociale, gjykata do ta ndryshojë vendimin për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve dhe për marrëdhëniet e ish-bashkëshortëve të shkurorëzuar me fëmijët e tyre të përbashkët. Në këtë drejtim është dhe vendimi i Gjykatës Supreme të RMV-së, sipas së cilit, punësimi i prindit të cilit i është caktuar fëmija, si fakt në vetvete, nuk mund të përbëjë gjithmonë arsye që të konsiderohet

¹¹³ Neni 79, paragrafi 5 i Ligjit për Familjen

¹¹⁴ Neni 80, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

¹¹⁵ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, 2015, fq. 225

se ekzistojnë rrethana të ndryshuara që kushtëzojnë dhe ndryshimin e vendimit për caktimin e fëmijës për rritje dhe edukim.¹¹⁶

Përveç rastit të shkurorëzimit të martesës, gjykata do të vendosë për besimin e fëmijëve për ruajtje dhe edukim edhe kur sjell aktgjykim me të cilin vërtetohet se martesa është e pavlefshme, si dhe në rastet e kontesteve për vërtetimin ose kundërshtimin e atësisë ose amësisë, nëse sjellja e vendimit, parë nga rrjedha e kontestit dhe rrethanat e rastit, është e mundur dhe e nevojshme.¹¹⁷ Megjithatë, kur sjell vendim për t'i besuar fëmijët për ruajtje dhe edukim, gjykata nëse është e nevojshme, do ta detyrojë palën tek e cila janë fëmijët, që në afat të caktuar t'i dorëzojë te prindi, respektivisht te person tjetër ose institucion. Pas anulimit ose shkurorëzimit të martesës, në aspekt të ushtrimit të së drejtës prindërore dhe rregullimit të marrëdhënieve personale dhe kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijëve me prindin tek i cili nuk janë besuar, Qendra ka të njëjtat autorizime që ka edhe kur prindërit janë të martuar.¹¹⁸

3.2 Procedura jashtëkontestimore për marrjen e të drejtave prindërore, përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe kthimin e të drejtave prindërore

3.2.1 Objekti i procedurës

Me lindjen e fëmijëve (martesorë ose jashtëmartesorë) krijohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve. Marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve bazohen në të drejtat dhe detyrimet e prindërve për t'u kujdesur për rritjen, ruajtjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre dhe për zhvillimin e aftësive për punë dhe zakoneve të tyre (e ashtuquajtura e drejtë apo përgjegjësi prindërore). Të drejtën prindërore e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve për t'u kujdesur për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur, si dhe të fëmijëve mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore.¹¹⁹

¹¹⁶ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 202

¹¹⁷ Neni 81, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

¹¹⁸ Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, 2015, fq. 226

¹¹⁹ Neni 44 i Ligjit për Familjen

E drejta prindërore i takon njësoj nënës dhe babait të fëmijës. Të drejtën prindërore prindërit e ushtrojnë së bashku në përputhje me nevojat dhe interesat e fëmijëve dhe të shoqërisë. Në rastet kur njëri nga prindërit ka vdekur, nuk është i njohur, i është hequr e drejta prindërore ose për arsye të tjera nuk ka mundësi ta ushtrojë të drejtën prindërore, të drejtën prindërore e ushtron prindi tjetër.

Në ushtrimin e të drejtës së tyre prindërore, prindërit janë të detyruar të udhëhiqen së pari nga interesat e fëmijës, duke u kujdesur për jetën, shëndetin, edukimin, shkollimin dhe aftësimin profesional të tyre dhe duke i përgatitur fëmijët për jetë dhe punë të pavarur. megjithatë, ka raste kur në ushtrimin e të drejtës prindërore, prindërit udhëhiqen nga interesa dhe nevoja të tjera, si dhe raste kur ata e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore. Në këto raste prindit mund t'i hiqet e drejta prindërore ose t'i kufizohet ushtrimi i të drejtës prindërore sipas kushteve të parashikuara në Ligjin për familjen.¹²⁰

Prindit që e ka keqpërdorur ushtrimin e të drejtës prindërore ose e ka neglizhuar rëndë ushtrimin e detyrimeve prindërore i merret ushtrimi i të drejtës prindërore në procedurë të veçantë jashtëkontestimore, pasi është siguruar dhe mendimi i Qendrës për punë sociale, si organ që kontrollon ushtrimin e të drejtës prindërore.¹²¹

Procedura për marrjen e të drejtave prindërore është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore dhe Ligjit për familjen. Sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, gjykata vërteton nëse ekzistojnë arsye që prindit t'i merret ushtrimi i të drejtave prindërore. Me marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore nënkuptohet dhe përcaktimi që prindi të ketë pozitën e kujdestarit.¹²² Përcaktimi që prindi të ketë pozitën e kujdestarit, në fakt, përbën kufizim të të drejtave prindërore në aspekt të administrimit të pasurisë së fëmijës, që do të thotë se prindi (i cili tashmë ka pozitën e kujdestarit) nuk mundet pa miratim paraprak nga Qendra për punë sociale të ndërmarrë punë të cilat i kalojnë kufijtë e administrimit të zakonshëm të pasurisë së fëmijës.¹²³

¹²⁰ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 103

¹²¹ Neni 90 i Ligjit për Familjen

¹²² Neni 106 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹²³ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 103

Ligji për procedurë jashtëkontestimore nuk i përcakton arsyet për të cilat prindit i merret e drejta prindërore. Dispozitat për këtë gjenden në Ligjin për familjen, ku përfshihet një normë interpretuese për kuptimin e “keqpërdorimit”, respektivisht “neglizhimit të ushtrimit të të drejtës prindërore”. Konsiderohet se prindi e keqpërdor të drejtën prindërore ose i neglizhon rëndë detyrimet prindërore nëse¹²⁴:

- a) ushtron dhunë fizike ose emocionale ndaj fëmijës;
- b) e shfrytëzon seksualisht fëmijën;
- c) e detyron fëmijën të bëjë punë që nuk i përshtaten moshës së tij;
- d) i lejon përdorimin e alkoolit, drogës ose substancave të tjera psikotrope;
- e) e shtyn fëmijën drejt sjelljeve të papranueshme nga shoqëria;
- f) e ka braktisur fëmijën dhe për më tepër se tre muaj nuk është kujdesur për të dhe
- g) në ndonjë mënyrë tjetër i ka cenuar rëndë të drejtat e fëmijës.

E drejta prindërore mund t’i merret njërit ose të dy prindërve. Prindit ose prindërve mund t’i merret ushtrimi i të drejtave prindërore në lidhje me të gjithë fëmijët ose me ndonjë prej tyre.

Pas pushimit të arsyeve për të cilat prindit/prindërve u është marrë e drejta prindërore ose është përcaktuar që ata të kenë rolin e kujdestarit, kthehet përsëri ushtrimi i të drejtave prindërore.¹²⁵

3.2.2 Kompetenca vendore e gjykatës

Kompetenca vendore e gjykatës në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore është e përcaktuar si *forum electivum*: për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore kompetencën vendore e ka gjykata në territorin e së cilës ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi ndaj të cilit inicohet procedura ose gjykata në territorin e së cilës ka vendbanimin ose vendqëndrimin fëmija.¹²⁶ Zgjedhjen e gjykatës me kompetencë vendore në çdo rast konkret e bën propozuesi. Nëse procedura ndaj të njëjtit prind apo ndaj të njëjtëve prindër inicohet në dy gjykata të ndryshme, procedurën e përfundin gjykata në të cilën është inicuar më parë procedura.¹²⁷

¹²⁴ Neni 90, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

¹²⁵ Neni 106 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore; Neni 92 i Ligjit për Familjen

¹²⁶ Neni 107, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹²⁷ Neni 107, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

3.2.3 Inicimi dhe zhvillimi i procedurës

Procedura për marrjen e të drejtave prindërore, për përcaktimin që prindi të ketë pozitën e kujdestarit, si dhe për kthimin e të drejtave prindërore iniciohet me propozim.

Ka njëfarë mospërputhje mes dispozitave të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore dhe Ligjit për familjen sa i takon rrethit të propozuesve të autorizuar. Sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, procedura për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore iniciohet me propozim të prindit tjetër ose të Qendrës për punë sociale.¹²⁸ Ligji për familjen, megjithatë, përveç subjekteve të mësipërm, në rrethin e propozuesve të autorizuar përfshin dhe prokurorin publik.¹²⁹ Qendra për punë sociale është e detyruar të iniciojë procedurë për marrjen e të drejtës prindërore, kur në çfarëdo lloj mënyre, ka dijeni se për këtë ekzistojnë arsye të përcaktuara me ligj, si dhe ka detyrimin të marrë masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.¹³⁰

Nga ana tjetër, sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, propozim për kthimin e të drejtave prindërore mund të parashtrojë: prindi të cilit i është marrë ushtrimi i këtyre të drejtave, prindi tjetër dhe Qendra për punë sociale.¹³¹ Sipas Ligjit për familjen, propozim për kthimin e të drejtave prindërore mund të parashtrojë prindi ose Qendra për punë sociale,¹³² por është e paqartë nëse termi “prindi” nënkupton vetëm prindin të cilit i është marrë ushtrimi i të drejtave prindërore apo edhe prindin tjetër.

Nëse i mituri në lidhje me të cilin zhvillohet kjo procedurë është pronar i pasurive të paluajtshme, inicimi i procedurës shënohet dhe në librat publikë të kadastrës.¹³³

Për vërtetimin e rrethanave nga të cilat del se ekzistojnë arsye për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, respektivisht për kthimin e të drejtave prindërore, gjykata gjatë zhvillimit të procedurës është e detyruar ta dëgjojë propozuesin, prindin ndaj të cilit zhvillohet procedura nëse kjo është e mundur, prindin ndaj të cilit nuk zhvillohet procedura nëse ai është propozues, si dhe persona të tjerë që mund të japin njoftime të nevojshme.¹³⁴

¹²⁸ Neni 108, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹²⁹ Neni 91, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

¹³⁰ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, “Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo”, Skopje, 2010, fq. 104

¹³¹ Neni 108, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹³² Neni 92, paragrafi 2 i Ligjit për Familjen

¹³³ Neni 108, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹³⁴ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, “Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo”, Skopje, 2010, fq. 105

Ligji për procedurë jashtëkontestimore nuk e parashikon detyrimin e gjykatës për ta thirrur dhe për ta dëgjuar fëmijën, por gjykata mund ta bëjë këtë nëse dëgjimi i fëmijës është i nevojshëm për vërtetimin e rrethanave thelbësore dhe nëse kjo nuk ndikon dëmshën në shëndetin psikik të fëmijës.¹³⁵

Në aspekt të vërtetimit të fakteve dhe paraqitjes së provave në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore, vlen parimi i hetimit. Mbajtja e seancën në këtë procedurë nuk është e detyrueshme në bazë të ligjit, por gjykata mund të vendosë për të mbajtur seancë, nëse vlerëson se kjo është e nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore publiku është i përjashtuar.

Sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, nëse propozimi për kthimin e të drejtave prindërore nuk është paraqitur nga Qendra për punë sociale, gjykata duhet të kërkojë dhe mendimin e saj.¹³⁶ Në fakt, mendim të Qendrës për punë sociale gjykata duhet të kërkojë dhe në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, sepse edhe kjo procedurë mund të iniciohet me propozim të një propozuesi tjetër të autorizuar (prindi tjetër, prokurori publik). Pavarësisht faktit nëse bëhet fjalë për marrjen ose për kthimin e të drejtave prindërore, gjykata është e detyruar të sigurojë mendimin e Qendrës për punë sociale nëse procedura nuk është iniciuar me propozim të saj. Ky detyrim i gjykatës rrjedh nga pozita e Qendrës për punë sociale, si organ që kontrollon ushtrimin e të drejtës prindërore.

3.2.4 Aktvendimi dhe pasojat juridike të aktvendimit

Nëse gjykata vërteton se ekzistojnë arsye që prindit t'i merret ushtrimi i të drejtave prindërore, sjell aktvendim me të cilin e miraton propozimin dhe prindit/prindërve ia merr ushtrimin e të drejtave prindërore. Nëse nuk ekzistojnë arsye për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, gjykata me aktvendim e refuzon propozimin.

Në aktvendimin për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore përcaktohen të drejtat që prindi nuk mund t'i ushtrojë ndaj fëmijës së tij. Këto të drejta në të ardhmen do t'i ushtrojë prindi

¹³⁵ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 105

¹³⁶ Neni 109, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

tjetër, ose nëse ai ka vdekur, nuk është i njohur ose për arsye të tjera nuk mund ta ushtrojë të drejtën prindërore, Qendra për punës sociale do t'i caktojë kujdestar fëmijës.¹³⁷

Me aktvendimin me të cilin përcaktohet që prindi të ketë pozitën e kujdestarit kufizohen të drejtat e prindit në aspekt të administrimit të pasurisë së fëmijës. Prindit që ka pozitën e kujdestarit në të ardhmen do t'i nevojitet miratim paraprak nga Qendra për punë sociale për ndërmarrjen e punëve që i tejkalojnë kufijtë e administrimit të rregullt me pasurinë e fëmijës.

Me aktvendimin për kthimin e të drejtave prindërore përcaktohet që prindit/prindërve t'u kthehen të drejtat që ai/ata i kanë pasur ndaj fëmijës/fëmijëve të tyre në përputhje me Ligjin për familjen, përpara marrjes së ushtrimit të së drejtës prindërore.

Aktvendimi për:

- a) marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore,
- b) përcaktimin që prindi/prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe
- c) kthimin e të drejtave prindërore

ka karakter konstitutiv.

Natyra konstitutive e këtyre aktvendimeve buron nga ajo se me këto aktvendime krijohet gjendje e re juridike në marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve në raport me gjendjen që ka ekzistuar deri atëherë.

Aktvendimet e mësipërme sjellin pasoja ndaj të gjithë subjekteve në marrëdhënien juridiko-prindërore, që do të thotë jo vetëm ndaj prindit kundër të cilit zhvillohet procedura, por edhe ndaj subjekteve të tjerë në marrëdhënien juridiko-prindërore, që janë prindi tjetër dhe fëmija/fëmijët.

Aktvendimin e plotfuqishëm për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore gjykata ia dorëzon nëpunësit kompetent të gjendjes civile për ta regjistruar në librin amzë të të lindurve.¹³⁸ Ligji për procedurë jashtëkontestimore ka mangësi sepse mungon dispozita sipas së cilës aktvendimi i plotfuqishëm për marrjen e të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore duhet të dorëzohet dhe tek organi që udhëheq librat publikë ku regjistrohen të drejtat mbi paluajtshmëritë nëse personi i mitur është pronar i një pasurie të

¹³⁷ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 105

¹³⁸ Neni 111 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

paluajtshme, duke pasur parasysh edhe faktin se iniciimi i procedurës shënohet në këto libra publikë.¹³⁹

Për shkak të vlefshmërisë së kufizuar kohore dhe mundësisë për të zhvilluar procedurë të kundërt për kthimin e të drejtave prindërore, vihet në pikëpyetje vlefshmëria materiale e aktvendimit për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore.

3.2.5 Mjetet juridike

Kundër aktvendimit të marrë në shkallë të parë në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore mund të paraqitet ankesë. Të legjitimuar për paraqitjen e ankesës janë: prindi të cilit i referohet aktvendimi, prindi tjetër dhe Qendra për punës sociale nëse procedura është iniciuar me propozim të tyre.¹⁴⁰

Kundër aktvendimit të plotfuqishëm të miratuar në procedurën për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e të drejtave prindërore nuk lejohet revizion.

3.2.6 Shpenzimet e procedurës

Lidhur me shpenzimet e procedurës për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore, për përcaktimin që prindërit të kenë pozitën e kujdestarit dhe për kthimin e të drejtave prindërore zbatohet dispozita e përgjithshme e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore sipas së cilës shpenzimet e procedurës i ngarkohen pjesëmarrësit në interes të së cilit është zhvilluar procedura.¹⁴¹

¹³⁹ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, “Gragjansko procesno pravo – kniga vtorā – Vonparnicno pravo”, Skopje, 2010, fq. 106

¹⁴⁰ Neni 110 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹⁴¹ Neni 32 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

KAPITULLI IV

PROCEDURA JASHTËKONTESTIMORE PËR VAZHDIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE PRINDËRORE PAS MOSHËS MADHORE

4.1 Vazhdimi i të drejtës prindërore pas moshës madhore

Parakushti kryesor për ekzistencën e të drejtës prindërore është fakti se fëmijët e mitur nuk janë fizikisht dhe mendërisht të pjekur për t'u kujdesur për personalitetin e tyre dhe për të drejtat dhe interesat e tyre. Me arritjen e moshës madhore ata arrijnë pjekurinë fizike dhe psikike me ç'rast rendi juridik u njih zotësinë e plotë për të vepruar. Megjithatë, nëse edhe pas arritjes së moshës 18 vjeçare, për shkak të pengesave në zhvillimin psikik, fëmija nuk është i aftë të kujdeset vetë për personalitetin, të drejtat dhe interesat e veta, ligji parashikon mundësinë që prindërit të vazhdojnë të ushtrojnë të drejtën prindërore. Për vazhdimin e të drejtës prindërore kompetente është gjykata, që vendos për këtë në procedurë jashtëkontestimore. Sipas Ligjit për familjen, propozimin në gjykatë mund ta dorëzojnë prindërit ose Qendra për punë sociale.¹⁴² Gjykata vendos në bazë të fakteve me të cilat vërtetohet se personi nuk është mendërisht i aftë të kujdeset për personalitetin, të drejtat dhe interesat e veta.¹⁴³

Vazhdimi i të drejtës prindërore nuk ka karakter të përhershëm sepse varet nga ndryshimet në zhvillimin psikik të fëmijës. Kështu që, me ndërprerjen e arsyeve për të cilat është vazhduar e drejta prindërore, me propozim të prindërve ose të Qendrës për punë sociale, gjykata do të vendosë për ndërprerje e së drejtës prindërore. Për shkak të mbrojtjes së interesave të të miturit, vendimi i gjykatës për vazhdimin e së drejtës prindërore, si dhe për ndërprerjen e saj, regjistrohet në librin amzë të të lindurve dhe në librat për evidentimin e pasurive të paluajtshme.¹⁴⁴

4.2 Procedura jashtëkontestimore për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore

¹⁴² Neni 94 i Ligjit për Familjen

¹⁴³ Liljana Spirovik-Trpenovska, Dejan Micovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2013, fq. 217

¹⁴⁴ Dejan Mickovik, Angel Ristov, Semejno pravo, Skopje, 2015, fq. 243

Derisa fëmijët të mbushin moshën madhore, ata janë përgjegjësi e prindërve. Ky është ligji. Megjithatë, kjo vijë ndarëse mund të zgjerohet në varësi të legjislacionit të çdo vendi. Në RMV kjo bëhet me vendim gjykate të sjellë në procedurë jashtëkontestimore, të rregulluar me ligj.

4.2.1 Objekti i procedurës

E drejta prindërore, si tërësi e të drejtave dhe detyrimeve të prindërve për t'u kujdesur për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre, përfundon me arritjen e moshës madhore të fëmijës, me lidhjen e martesës nga fëmija përpara arritjes së moshës madhore dhe me adoptim. Në dy rastet e para fëmija fiton zotësinë për të vepruar, prandaj supozohet se është i aftë të kujdeset për veten dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të veta. Ndërsa, me adoptim, ndërpritet e drejta prindërore e prindërve të deriatëhershëm të fëmijës dhe krijohet e drejtë e re prindërore për adoptuesit.¹⁴⁵

E drejta prindërore mund të vazhdohet dhe pas arritjes së moshës madhore të fëmijës nëse ai për shkak të pengesave në zhvillimin psikik nuk është i aftë të kujdeset vetë për personalitetin e vet dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të veta. Vazhdimi i ushtrimit të së drejtës prindërore pas moshës madhore kryhet në procedurë të veçantë jashtëkontestimore të rregulluar me Ligjin për procedurë jashtëkontestimore dhe Ligjin për familjen.

Në procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, gjykata vendos për vazhdimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve nëse fëmija edhe pas moshës madhore për shkak të pengesave në zhvillimin psikik nuk i është i aftë të kujdeset vetë për veten dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të veta.¹⁴⁶

Si arsye për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore paraqiten ekskuzivisht pengesat në zhvillimin psikik të fëmijës, për shkak të të cilave ai nuk mund të kujdeset për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të veta. Të metat fizike ose trupore të fëmijës nuk përbëjnë shkak për vazhdimin e të drejtës prindërore pas moshës madhore. Gjithashtu, fakti që fëmija nuk e ka përfunduar arsimin e detyrueshëm (fillor, të mesëm), fakti që është larguar disa herë nga shtëpia, fakti që ka sjellje të dhunshme, etj., nuk

¹⁴⁵ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 107

¹⁴⁶ Neni 112, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore, Neni 94, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

përbën arsye për të cilën e drejta prindërore mbi fëmijën duhet të vazhdohet pas moshës madhore.¹⁴⁷

Me ndërprerjen e arsyeve për të cilat e drejta prindërore është vazhduar pas moshës madhore, me propozim të propozuesve të autorizuar mund të iniciohet procedurë për ndërprerjen e së drejtës prindërore, e cila me vendim të gjykatës është vazhduar pas moshës madhore.

4.2.2 Kompetenca vendore e gjykatës

Edhe në procedurën për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, kompetenca vendore e gjykatës përcaktohet si *forum electivum*: kompetencën vendore e ka gjykata në territorin e së cilës prindi ka vendbanimin ose vendqëndrimin dhe gjykata në territorin e së cilës fëmija ka vendbanimin ose vendqëndrimin.¹⁴⁸ Zgjedhjen e gjykatës me kompetencë vendore në rastin konkret e bën propozuesi. Nëse procedurë është iniciuar përpara dy gjykatave me kompetencë vendore, procedurën e përfundon gjykata e cila e ka filluar e para procedurën.

4.2.3 Iniciimi dhe zhvillimi i procedurës

Në aspekt të inicimit të procedurës për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, del në pah parimi i dispozitivitetit. Procedura iniciohet me propozim të prindërve të fëmijës ose të Qendrës për punë sociale.¹⁴⁹ Konsiderohet se propozim për inicimin e kësaj procedure mund të parashtrojë dhe vetëm njëri prej prindërve, madje edhe kur prindërit e ushtrojnë së bashku të drejtën prindërore.

Nëse kemi parasysh efektet që duhet të prodhojë procedura për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, është e kuptueshme që ligjvënësi ka parashikuar se kjo procedurë iniciohet dhe përfundon përpara arritjes së moshës madhore të fëmijës.¹⁵⁰ Qëllimi i procedurës për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore është të pengohet fitimi i zotësisë së përgjithshme për të vepruar, që fitohet me arritjen e moshës madhore, gjë që mund të arrihet vetëm nëse procedura iniciohet dhe përfundon përpara arritjes së moshës madhore të fëmijës. Nëse kjo nuk bëhet, atëherë fëmija

¹⁴⁷ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorā – Vonpārnichno pravo", Skopje, 2010, fq. 107

¹⁴⁸ Neni 113 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹⁴⁹ Neni 114 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore; Neni 94, paragrafi 1 i Ligjit për Familjen

¹⁵⁰ Neni 112, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

fiton zotësinë e përgjithshme për të vepruar dhe nëse ai nuk është i aftë të kujdeset për veten dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të veta, do të duhet të iniciohet procedurë për heqjen e zotësisë për të vepruar të personit dhe për vendosjen e tij nën kujdestari. Me kufizimin kohor që procedura të fillojë dhe të përfundojë përpara arritjes së moshës madhore të fëmijës, sigurohet kontinuitet në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore.¹⁵¹

Për shkak të pasojave që duhet të prodhojë procedura për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, në procedurë del në pah parimi i urgjencës, të cilit gjykata duhet t'i përmbahet gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale.

Në procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, gjykata ka për detyrë të vërtetojë faktet e rëndësishme nga të cilat varet sjellja e vendimit, si p.sh.:

- a) a ekzistojnë pengesa në zhvillimin psikik të fëmijës dhe
- b) a e pamundësojnë këto pengesa që edhe pas moshës madhore fëmija të mos jetë i aftë të kujdeset vetë për personalitetin, të drejtat dhe interesat e veta?

Për shkak të vërtetimit të këtyre fakteve të rëndësishme gjykata është e detyruar të ndërmarrë disa veprime procedurale. Kështu, gjykata ka detyrimin ta dëgjojë të miturin me kushtin që ai të jetë në gjendje dhe kjo të mos ndikojë negativisht në shëndetin e tij. Gjukata ka detyrimin t'i dëgjojë dhe prindërit e fëmijës, si dhe Qendrën për punë sociale.

Për dallim nga procedura për heqjen e zotësisë për të vepruar, në të cilën gjykata për shkak të vërtetimit të gjendjes së shëndetit mendor të personit ka detyrimin të caktojë ekzaminim gjyqësor, në procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore ligji parashikon detyrimin e gjykatës të sigurojë mendimin e një mjeku specialist për gjendjen psikike të të miturit.¹⁵² Pra, për përcaktimin e rrethanave me rëndësi të njëjtë, Ligji për procedurë jashtëkontestimore ka parashikuar veprime procedurale të ndryshme, gjë që nuk është e justifikuar. Duke pasur parasysh se vazhdimi i të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore përfshin dhe pasojat e heqjes së zotësisë për të vepruar, duhet që

¹⁵¹ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtora – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 108

¹⁵² Neni 115, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

edhe në procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore të parashikohet ekzaminim gjyqësor i të miturit.¹⁵³

4.2.4 Aktvendimi dhe pasojat juridike të aktvendimit

Pasi të vërtetohen faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit, gjykata sjell aktvendim me të cilin e miraton propozimin nëse është i bazuar dhe cakton vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore ose aktvendim me të cilin e refuzon propozimin nëse është i pabazuar.

Aktvendimi për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore është vendim me natyrë konstitutive. Me këtë aktvendim ndalohet fitimi i zotësisë së përgjithshme për të vepruar të personit, për shkak se aktvendimi për nga pasojat që sjell barazohet me aktvendimin për heqjen e zotësisë për të vepruar. Dallimi qëndron në atë se tek heqja e zotësisë për të vepruar, personi e ka fituar zotësinë e veprimit, dhe mbas kësaj i hiqet tërësisht ose pjesërisht për shkaqe të përcaktuara me ligj, ndërsa tek vazhdimi i të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore ndalohet apo pengohet fitimi i zotësisë së përgjithshme për të vepruar.

Aktvendimi i plotfuqishëm për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore i dorëzohet organit kompetent që udhëheq librat amzë të të lindurve për regjistrim. Nëse personi mbi të cilin vazhdon e drejta prindërore ka pasuri të paluajtshme, aktvendimi i plotfuqishëm për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore i dorëzohet dhe organit kompetent që udhëheq librat publikë për të bërë shënimin në librat publikë. Qëllimi është që personat e tretë të vihen në dijeni të faktit se është vazhduar e drejta prindërore mbi personin edhe pasi ai ka arritur moshën madhore, kështu që, në qarkullimin juridik në emër dhe për llogari të personit do të veprojnë prindërit e tij.

4.2.5 Mjetet juridike

¹⁵³ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtora – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 109

Kundër aktvendimit për vazhdimin e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore të sjellë në shkallë të parë mund të paraqitet ankesë. Ankesë mund të paraqesin prindërit e fëmijës dhe Qendra për punë sociale. Afati për paraqitjen e ankesës është 8 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit, që është përjashtim nga afati i përgjithshëm për ankesë kundër aktvendimit në procedurë jashtëkontestimore, që është 15 ditë.¹⁵⁴

Në procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, ankesa nuk ka efekt suspensiv – ajo nuk e ndërpret përmbushjen e aktvendimit. Kjo është e kuptueshme nëse kemi parasysh efektin e aktvendimit – ndalimin e fitimit të zotësisë së përgjithshme për të vepruar, që mund të vihet në pikëpyetje nëse aktvendimi ka efekt suspensiv. Duke pasur parasysh urgjencën e procedurës, ligji parashikon detyrimin e gjykatës së shkallës së dytë të sjellë vendim sipas ankesës në afat 8 ditor.¹⁵⁵ Afati fillon të rrjedhë nga momenti i pranimit të ankesës në gjykatën e shkallës së dytë.

Kundër aktvendimit të plotfuqishëm të sjellë në procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore nuk lejohet revizion.

Siç u përmend më sipër, pas ndërprerjes së shkaqeve për të cilat janë vazhduar të drejtat dhe detyrimet prindërore pas moshës madhore, me propozim të propozuesve të autorizuar mund të zhvillohet procedurë për ndërprerje e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore. Në këtë procedurë zbatohen në mënyrë analoge dispozitat e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore që kanë të bëjnë me procedurën për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore.¹⁵⁶ Bëhet fjalë për dispozitat që kanë të bëjnë me: kompetencën vendore të gjykatës, faktet e rëndësishme që gjykata duhet t'i vërtetojë në procedurë dhe mënyrën e vërtetimit të tyre, ankesën kundër aktvendimit dhe detyrimin për dorëzimin e aktvendimit të plotfuqishëm. Për këto çështje, në procedurën për ndërprerjen e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore vlen ajo që u përmend më sipër për procedurën për vazhdimin e ushtrimit të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore.

¹⁵⁴ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, "Gragjansko procesno pravo – kniga vtorá – Vonparnicno pravo", Skopje, 2010, fq. 110

¹⁵⁵ Neni 116, paragrafi 3 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹⁵⁶ Neni 113, 115 dhe 117 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

Procedura për ndërprerjen e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore iniciohet me propozim të fëmijës, të prindërve të fëmijës dhe të Qendrës për punë sociale.¹⁵⁷ Për dallim nga procedura për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore kjo procedurë mund të iniciohet dhe nga fëmija. Bëhet fjalë për përjashtim nga rregulli i përgjithshëm sipas të cilit vetëm personat që kanë zotësi për të vepruar mund të ndërmarrin veprime procedurale në mënyrë të pavarur. Ky autorizim i korespondon autorizimit të personit të cilit i është hequr zotësia për të vepruar për të paraqitur propozim për kthimin e zotësisë për të vepruar.¹⁵⁸

Aktvendimi për ndërprerjen e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore ka natyrë konstitutive. Efekti konstitutiv i aktvendimit shfaqet në atë se me hyrjen në fuqi të aktvendimit për ndërprerjen e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore, personi mbi të cilin ishte vazhduar e drejta prindërore konsiderohet i aftë për të vepruar.

4.2.6 Shpenzimet e procedurës

Të gjitha shpenzimet që krijohen gjatë zhvillimit të procedurës për vazhdimin dhe për ndërprerjen e të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore i ngarkohen propozuesit.¹⁵⁹

¹⁵⁷ Neni 118, paragrafi 2 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

¹⁵⁸ Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska, “Gragjansko procesno pravo – kniga vtorā – Vonpāmicno pravo”, Skopje, 2010, fq. 111

¹⁵⁹ Neni 119 i Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore

KAPITULLI V

TË DHËNA NGA GJYKATA THEMELORE CIVILE SHKUP LIDHUR ME PROCEDURAT JASHTËKONTESTIMORE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE FAMILJARE NGA VITI 2015 E KËNDEJ

5.1 Të dhëna nga Gjykata Themelore Civile Shkup lidhur me procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare për periudhën 2015 e këndej

Në Gjykatën Themelore Civile Shkup nga viti 2015 e deri më sot janë paraqitur gjithsej 6 propozime për inicim të procedurës jashtëkontestimore për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Nga këto 6 propozime janë miratuar me aktvendim 2 prej tyre, ndërsa janë tërhequr 3 propozime. Dy propozimet e miratuara me aktvendim kanë të bëjnë me dhënien e lejes për lidhjen e martesës për personine mitur. Propozimi për dhënien e lejes për lidhjen e martesës është paraqitur nga e mitura, të cilës në të dyja rastet i është lejuar me aktvendim lidhja e martesës.

Në rastin e parë, e mitura 17 vjeçare nga Shkupi u lejua të lidh martesë me një shtetas belg, me të cilin jetonte prej më shumë se një viti në Belgjikë, ku dhe do të vazhdonin të jetonin në bashkësi me prindërit e tij pas lidhjes së martesës.

Në rastin e dytë, e mitura 17 vjeçare nga Shkupi u lejua të lidhë martesë me shtetasin e RMV-së me të cilin jetonte prej disa muajsh, në bashkësi dhe me prindërit e tij, dhe mbas lidhjes së martesës do të zhvendoseshin për të jetuar në Austri.

Tab 1. Numri i lëndëve për rregullimin e marrëdhënieve familjare

Viti 2015-2022	Të dhëna lidhur me procedurën jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare
Propozime të paraqitura	6
Propozime të tërhequra	3

Propozime të miratuara	2
Viti 2015-2022	Llojet e procedurave jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare
Procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës	2
Procedurapër marrjen dhe kthimin e të drejtave prindërore	0
Procedurapër vazhdimin e të drejtës prindërore pas modhës madhore	0

Përfundime dhe Rekomandime

Procedurat jashtëkontestimore për rregullimin e gjendjeve familjare kanë një rëndësi të veçantë dhe përveç parimeve të përgjithshme të procedurës jashtëkontestimore udhëhiqen dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, që është një nga parimet bazë të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Mituria është një nga pengesat kryesore për lidhjen e martesës dhe shkak për pavlefshmëri absolute të martesës. Megjithatë, mituria si pengesë për lidhjen e martesës mund të shmanget me vendim gjykate të marrë në procedurë jashtëkontestimore, kur ekzistojnë parakushtet e përcaktuara me ligj për lejimin e lidhjes së martesës nga persona të grup-moshës 16-18 vjeç. Po ashtu, nuk mund të lidhin martesë as personat të cilët janë në gjini krushqie me njëri-tjetrin, por edhe kjo pengesë mund të shmanget me vendim gjykate marrë në procedurë jashtëkontestimore, kur ekzistojnë parakushtet e përcaktuara me ligj për lejimin e martesës midis personave në gjini krushqie.

Me lindjen e fëmijëve krijohen marrëdhënie prindër fëmijë. Këto marrëdhënie bazohen tek të drejtat dhe detyrimet që prindërit kanë ndaj fëmijëve. Në të drejtën familjare bashkëkohore theksi vihet tek përgjegjësia prindërore. Prindërve, të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore ose e neglizhojnë përmbushjen e detyrimeve prindërore mund t'u hiqet ushtrimi i të drejtës prindërore nga gjykata në procedurë jashtëkontestimore të përcaktuar me ligj.

E drejta prindërore është tërësi të drejtash dhe detyrimesh që prindi të kujdeset për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve, e cila përfundon me arritjen e moshës madhore të fëmijës, me lidhjen e martesës së fëmijës përpara moshës 18 vjeç dhe me adoptimin. Por, e drejta prindërore mund të vazhdohet edhe pas arritjes së moshës madhore kur fëmija për shkak të pengesave në zhvillimin psikik nuk është në gjendje të kujdeset për veten dhe t'i mbrojë të drejtat dhe interesat e tij. Vazhdimi i të drejtave prindërore pas moshës madhore bëhet nga gjykata në procedurë jashtëkontestimore të përcaktuar me ligj. Gjatë procedurës jashtëkontestimore gjykata është e obliguar të kujdeset që sa më shpejt të përcaktohen dhe të sigurohen të drejtat e pjesëmarrësve.

Në bazë të hulumtimit të botimeve të ndryshme shkencore dhe analizës së legjislacionit kemi arritur në këto konkluzione dhe rekomandime:

- Procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës inicohet me propozim të personit të mitur që dëshiron të lidhë martesë. Nëse të dy personat që do të lidhin martesë janë të mitur atëherë ata duhet t'i paraqesin gjykatës një propozim të përbashkët.
- Procedura për dhënien e lejes për lidhjen e martesës midis personave në gjini krushqie inicohet me propozim të përbashkët të tyre drejtuar gjykatës.
- Leja për lidhjen e martesës nuk jepet për të lidhur martesë me cilindo person, por me person ekzaktësisht të përcaktuar në dispozitivin e aktvendimit.
- Lidhur me iniciimin e procedurës për marrjen e të drejtave prindërore, ka mospërputhje midis dispozitave të Ligjit për familjen dhe dispozitave të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore. Sipas Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, procedura inicohet nga prindi tjetër dhe nga Qendra për punë sociale, ndërsa sipas Ligjit për familjen, përveç personave të sipërpërmendur, ajo inicohet dhe nga prokurori publik. Rekomandojmë ndryshime të legjislacionit në fjalë për harmonizim të këtyre dispozitave.
- Po ashtu, lidhur me procedurën për kthimin e të drejtave prindërore ekziston njëfarë mospërputhje midis dispozitave të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore dhe Ligjit për familjen. Sipas Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore procedura mund të inicohet me propozim të: 1) prindit të cilit i është marrë ushtrimi i këtyre të drejtave, 2) prindit tjetër dhe 3) Qendrës për punë sociale. Ndërsa sipas Ligjit për familjen, procedura inicohet me propozim të: 1) prindit dhe 2) Qendrës për punë sociale. Në këtë rast nuk është e qartë nëse termi “prind” i referohet të dy prindërve apo vetëm prindit të cilit i është marrë ushtrimi i të drejtave prindërore. Rekomandojmë saktësim të Ligjit për familjen në aspekt të harmonizimit me Ligjin për procedurë jashtëkontestimore.
- Aktvendimin e plotfuqishëm për marrjen e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për kthimin e tyre gjykata duhet t'ia dorëzojë gjendjes civile për regjistrim në librin amzë të të lindurve. Mangësi e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore është se nuk parashikohet dorëzimi i aktvendimit edhe në organin kompetent kadastral që udhëheq librat publikë ku regjistrohen të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme. Rekomandojmë plotësim të ligjit në këtë drejtim, aq më tepër për arsye se iniciimi i procedurës shënohet në librat publikë të kadastrës, por jo dhe aktvendimi i plotfuqishëm me të cilin përfundon procedura.
- Procedura për vazhdimin e të drejtave prindërore pas moshës madhore inicohet me propozim të prindërve të fëmijës dhe Qendrës për punë sociale. Është e rëndësishme që

kjo procedurë të fillojë dhe të përfundojë përpara se i mituri të ketë arritur moshën madhore. Në të kundërt, nëse i mituri që për shkak të pengesave në zhvillimin mendor nuk mund të kujdeset për të drejtat dhe interesat e tij, arrin moshën madhore, atëherë do të zhvillohet procedurë jashtëkontestimore për heqjen e zotësisë së veprimit dhe vendosjen e të miturit nën kujdestari dhe jo më procedurë për vazhdimin e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindërore pas moshës madhore.

Literatura

- Aliu, Abdulla, E drejta civile, Prishtinë, 2013
- Aliu, Abdulla, Gashi, Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007
- Brestovci, Faik, E drejta e procedurës civile I, Prishtinë, 2004
- Cavdar, Kiril & Cvetanka S. Kostadinovska, Komentar na Zakonot za Semejstvoto: Sudska Praktika, Predmeten Registar, Primeri za Prakticna Primena, Pridruzni Propisi i Literatura, Akademik, Skopje, 2013
- Georgievski, Stefan, “Osnovni principi na gragjanska procesno pravo na R. Makedonija”, Monument, Skopje, 1995
- Gruda, Zejnullah, Të Drejtat e Fëmijës, Monografi për të Drejtat e Njeriut, nr. 9 Prishtinë, 2005
- Janevski, Arsen, Dostavljanje po zakonu o parničnom postipku, Republike Makedonije, Pravni zhivot, Broj 12, Beograd, 2006
- Janevski, Arsen, Zoroska-Kamilovska, E drejta procedurale civile – Libri i parë – E drejta kontestimore, Shkup, 2009
- Janevski, Arsen, Zoroska-Kamilovska, Gragjansko procesno pravo – Kniga vtora – Vonparnicno pravo, Skopje, 2010
- Mandro- Balili, Arta, Vjollca Mecaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, E Drejta Familjare, Tiranë, 2006
- Mandro, Arta, E Drejta Familjare - familja, fëmijët, martesë, bashkëshortët, Tiranë, 2009
- Mandro, Arta, E Drejta Familjare, Familja, Fëmijët, Martesë, Bashkëshortët, Tiranë, 2009
- Metaj-Stojanova, Albana, “Subjektiviteti i fëmijëve në të drejtën civile” në “Të drejtat e fëmijëve – Sfidat dhe perspektivat e reja”, Tetovë, 2022
- Metaj-Stojanova, Albana. A Comparative View on the Legal Protection of Family Home and the Current Situation in RM. In *Proceedings of the 11-th Annual South-East European Doctoral Student Conference: Infusing Research and Knowledge in South-East Europe*, pp. 109-119. South-East European Research Centre, Thessaloniki, Greece, 5 / 2017, marrënga: <https://www.seerc.org/yrw/2017/files/DSC2017-Proceedings.pdf>
- Mickovik, Dejan, Ristov, Angel, Semejno pravo, Stobi Trejd, Skopje, 2015
- Omari, Sonila, E Drejtë Familjare, Tiranë, 2007

- Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005
- Podvorica, Hamdi, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010
- Spirovik Trpenovksa, Liljana, Mickovik, Dejan, Ristov, Angel, Semejno pravo, Kulturna ustanova “Blesok”, Skopje, 2013
- Zhivkovska, Rodna, Opsht del na gragjanskoto pravo, Skopje, 2011

Akte normative

- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989)
- Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut
- Kushtetuta e RMV-së
- Ligji për familjen (Gazeta Zyrtare nr. 80/1992) – me ndryshime dhe plotësime
- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve
- Ligji për procedurë jashtëkontestimore i RMV-së (Gazeta Zyrtare nr. 9/2008)
- Ligji për procedurë kontestimore i RMV-së
- Ligji për të drejtën ndërkombëtare private i RMV-së